



TWINNING ALBANIA

DIGJITALIZIMI - BINJAKËZIMI
I SHKOLLAVE SHQIPTARE NË
HAPËSIRËN E PËRBASHKËT
EVROPIANE

VLERËSIMI I MËSUESVE

NJË POLITIKË E RE E
IDENTIFIKIMIT TË NEVOJAVE
PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL
TË MËSUESVE

SPORTI NË SHKOLLA

INVESTIM NË MASIVIZIMIN
DHE CILËSINË E SPORTIT
SHQIPTAR

MËSUESI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

“Mësuesi” është një revistë e përmuajshme kombëtare arsimore.

Botim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Adresa e redaksisë
Rruga e Durrësit nr. 23, Tiranë

Përgatiti për shtyp:
Vjollca Spaho
vjollca.spaho@arsimi.gov.al
Cel: +355 69 53 76 532

Design & print:
Shtëpia Botuese MORAVA

Rr. Gjon Kastrioti (Ish-Shtëpia e Pionierit) Laprakë Tiranë
Tel: 2 22 72 02



www.arsimi.gov.al

 Ministria e Arsimit dhe Sportit

Nr. i llogarisë rrjedhëse i MAS:
Raiffeisen Bank
për revistën “Mësuesi”
711 3006



GERON KAMBERI
Drejtor i Përgjithshëm, AKTI

INTERVISTA

**KËRKIMI SHKENCOR DUHET T’U
PARAPRIJË ME IDETË E TIJ ZHVILLIMEVE
NË FUSHA TË NDRYSHME**

Faqe 8



PROF. DR. ENGJËLL PËRE
UET

**CILAT JANË DEGËT E PREFERUARA
NË UNIVERSITETE?**

Faqe 15



VJOLLCA SPAHO

**SI TË INTERPRETOJMË NJE POEZI
NË ORËN E LETËRSISË**

Faqe 29



LUIZA MYRTAJ NEZHA
Drejtoreshë, shkollë “Kongresi i Manastirit”

**PUNA EKIPORE SI KONTRIBUT
PËR RRITJEN E CILËSISË NË SHKOLLË**

Faqe 31

TWINNING ALBANIA

Digjitalizimi - Binjakëzimi i shkollave shqiptare në hapësirën e përbashkët evropiane



Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të një vjetorit të aderimit të Shqipërisë në projektin e Komisionit Evropian “eTwinning”, organizoi një aktivitet ku mësuesit e përfshirë prezantuan projektet e tyre.

Janë 1403 mësues, 734 shkolla që janë bërë, për herë të parë, pjesë e komunitetin online të shkollave në mbarë Evropën. Gjatë këtij viti janë realizuar 81 projekte ku mësuesit shqiptarë kanë bashkëpunuar me mësues ndërkombëtarë si dhe 39 projekte kombëtare që kanë sjellë një metodologji të re, inovatore, mësimdhënieje dhe edukimi për nxënësit.

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, në fjalën e saj tha: “Gjithçka që shkollat dhe mësuesit përfitojnë përmes interaktivitetit me mësues nga e gjithë Evropa, ndikon më së miri në cilësinë e jetës së shkollës duke e bërë orën e mësimit më tërheqëse dhe duke rritur cilësinë e arritjeve të nxënësve”.

Ministrja shtoi se anëtarësimi

prej një viti i mësuesve shqiptarë në këtë projekt evropian është padyshim modeli i parë i suksesit, por dhe një mundësi e re që të gjitha shkollat e vendit dhe çdo mësues të ketë hapësirën e tij të përfitimit nga ky projekt.

“Digjitalizimi i sistemit arsimor, nga një anë dhe zhvillimi real profesional i mësuesve, nga ana tjetër janë shprehje e vullnetit tonë të qartë politik për transformimin e shkollës, sipas modeleve evropiane. Gjithashtu kurrikula e bazuar në kompetenca kërkon mësues të cilët, gjithnjë e më shumë, duhet të jenë krijues, hartues, bashkëpunues dhe që zgjedhin vet materialet mësimore. Ndaj edhe në këtë drejtim, platforma eTwinning është një shembull pozitiv se si mësuesit mund t’i arrijnë me profesionalizëm gjithë këto kërkesa”, deklaroi Nikolla.

Në fjalën e saj, Ministrja Nikolla theksoi se ky **projekt ambicioz**, tashmë është realitet për 14 mijë nxënës në sistemin arsimor parauniversitar që po mësojnë përmes platformës

“e-learning” në “klasat digjitale”.

Ministrja e Arsimit tha se Shërbimi Mbështetës Kombëtar për eTwinning në MAS ka zhvilluar dhe do të vijojë të zhvillojë trajnime me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave mbi promovimin dhe përdorimin e kësaj platforme si dhe për t’i nxitur mësuesit të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për realizimin e projekteve.

Krahas 1403 mësuesve që tashmë janë pjesë e eTwinning, Ministrja Nikolla ftoi të gjithë mësuesit e tjerë që të mos ngurojnë të bëhen pjesë aktive e këtij programi që ka në qendër inkurajimin dhe promovimin e projekteve në fushën e arsimit.

Në përfundim, Ministrja ndau tre çmime për projektet më të mira si dhe tre të tjera për festimet më të mira që shkollat dhe mësuesit realizuan në kuadër të 10-vjetorit të eTwinning. Gjithashtu mësuesve me 20 projektet më të mira ju dhuruan tableta për zhvillimin e mëtejshëm të projekteve të tyre, përmes programit eTwinning.

VLERËSIMI I MËSUESVE

Një politikë e re e identifikimit të nevojave për zhvillimin profesional të mësuesve



Ne duhet të bëjmë një vlerësim të situatës ku kryefjalë mbetet cilësia e mësuesit. Ky vlerësim na duhet për të ditur se ku janë nevojat për mbështetje për zhvillimin profesional të mësuesve

Më kuadër të një politike të re të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zhvillimin profesional të mësuesve, të gjithë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave që janë në marrëdhënie pune do të bëhen pjesë e instrumentit për identifikimin e nevojave për zhvillimin e tyre profesional. Drejtuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Tiranës si dhe mësuesit, u njohën sot, me qëllimin e kësaj iniciative dhe mënyrën se si ajo do të realizohet. Ministria Nikolla theksoi se ky proces nuk do të nxjerrë asnjë mësues nga sistemi, por do t'i jap fund informalitetit të procedurave për trajnimin e mësuesve. “Në fund të këtij procesi ne do të kemi një bazë të dhënash të plotë bazuar në një instrumente shkencor se cilat janë nevojat e çdo mësuese që është në sistemin e arsimit parauniversitar”, tha Nikolla. Ministria e Arsimit shpjegoi se, nga ky vlerësim në çdo shkollë do të krijohet dosja e nevojave për zhvillimin profesional të stafit pedagogjik si dhe MAS do të krijojë hartën kombëtare të nevojave për zhvillim profesional të detajuar, për çdo DAR/ZA.

“Mbi bazën e të dhënave që do të krijohen, Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, do ta ketë shumë herë më të qartë se ku do të investohen financat për zhvillimin profesional të mësuesve. Gjithashtu krijohet një mundësi më e mirë për zhvillimin profesional të mësuesve, i koordinuar nga MAS dhe institucione e varësisë”, tha ministria Nikolla. Ky proces do të realizohet përmes teknologjisë digjitale. Instrumenti për identifikimin e nevojave të punonjësve mësues do të fillojë nga Drejtoria Arsimore Tiranë. Janë rreth 1700 mësues të cilët do të marrin pjesë në testim, duke përfshirë ata që kanë arritur shkallën e parë të kualifikimit dhe kanë mbi 20 vite eksperiencë pune. Testimi do të zhvillohet në 6 qendra vlerësimi, që janë pjesë shkollave pilot të klasave inteligjente me tableta si, Partizani, Ismail Qemali, Petro Nini, Sami Frashëri, A.Z.Çajupi, Sinan Tafaj. Testimi do të zhvillohet online, me disa turne, në klasa me maksimumi 20 mësues. Instrumenti përmban 30 kërkesa me alternativa të cilat fokusohen kryesisht në situata nga konteksti real i shkollës, pavarësisht profilit apo ciklit ku mësuesi jep mësim. Instrumenti zhvillohet për 60 minuta

në formë digjitale.

Instrumenti do të vlerësojë 4 fusha siç janë planifikimi, aspekte metodike-pedagogjike, stili i komunikimit dhe etikës së përdorur nga punonjësit arsimor si edhe përgatitjen shkencore të mësuesve dhe zhvillimin e tyre profesional.

Në përfundim të procesit, mësuesi njihet menjëherë me përgjigjet në instrumentin e zhvilluar prej tij. Në varësi të rezultateve të instrumentit, për secilin mësues përcaktohen fushat ku ai ka nevojë për zhvillim profesional.

Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik është përgjegjëse për përgatitjen e programit të teknologjisë digjitale për vlerësimin online të mësuesve. Fondi i pyetjeve për çdo fushë të identifikimit të nevojave për trajnim do të krijohet nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Specialistët e IT të DAR/ZA do të asistojnë në çdo shkollë ekipet e mësuesve në mënyrë që të jetë e qartë si përdorimi i teknologjisë dhe metodologjia.

Statistikat e gjeneruara në çdo DAR/ZA do të japin një tablo të qartë të nevojave për çdo rajon dhe në nivel kombëtar sipas drejtimeve arsimore përkatëse.

EDUKIMI GLOBAL

Pjesë e kurrikulave mësimore dhe skemës së re të trajnimit të mësuesve



Një nga kompetencat bazë të edukimit global është aftësia e të kuptuarit të fakteve nëpërmjet nxitjes së multikulturalizmit dhe luftës ndaj stereotipeve

Instituti i Zhvillimit të Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Veri-Jug të deleguar nga Këshilli i Evropës, zhvilluan sot, për herë të parë në vendin tonë, seminarin “Edukimi Global”, me qëllim integrimin e edukimit global si pjesë e kurrikulave mësimore në vendin tonë dhe e skemës së re të zhvillimit profesional të mësuesve.

Një nga kompetencat bazë të edukimit global është aftësia e të kuptuarit të fakteve nëpërmjet nxitjes së multikulturalizmit dhe luftës ndaj stereotipeve. Edukimi global përfshin zhvillimin edukativ, edukimin mbi të drejtat e njeriut, edukimin për qëndrueshmëri, edukimin për paqe dhe reduktimin e konflikteve, elemente këto që përfaqësojnë përmasat globale të edukimit për një qytetari demokratike.

E pranishme në seminar ishte edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla e cila deklaroi se çështja e kompetencave është kryefjala e reformave që janë ndërmarrë në arsimin parauniversitar, me objektivin madhor që përmes shkollës mos të mundësohet vetëm dhënia e njohurive, por përmes shkollës të formohen qytetarë të suksesshëm të

një shoqërie demokratike.

“Ne kemi ambicien ta shohim veten të rreshtuar së bashku me vendet e tjera evropiane edhe në përpjekjet për të promovuar vlerat e përbashkëta, për të ngushtuar terrenin e dukurive negative, për të zgjidhur konfliktet dhe për të ofruar një cilësi të re në formimin e qytetarëve të një shoqërie evropiane. Qeveria shqiptare e ka prioritet arsimin pasi shikon që politika më e mirë ekonomike e zhvillimit të vendin është pikërisht investimi në arsim”, tha Nikolla.

Në fjalën e saj, Ministria Nikolla renditi proceset reformuese që MAS ka ndërmarrë për të mundësuar, ndër të tjera, përafrimin e sistemin arsimor parauniversitar me vendet e BE-së. Reforma kurrikulare, shkolla si qendër komunitare, digitalizimi, “Mësues për Shqipërinë”, tekstet e reja dhe së fundi vlerësimi i mësuesve për nevojën për trajnim, janë reformat në sistemin parauniversitar, të cilat ministria Nikolla i shpjegoi në fjalën e saj.

“Nuk do të ketë më emërimet në arsim që vijnë për shkak të asgjëje tjetër përveç meritës dhe transparencës. Kemi krijuar një proces të bazuar në teknikalitete

shkencore dhe profesionale, transparente për publikun ku gjithë punëkërkuessit renditen në çdo DAR/ZA dhe është vetëm kjo renditje që do të bëjë të mundur punësimet në arsim”, tha Nikolla duke ju referuar portalit “Mësues për Shqipërinë”, nismë e MAS në “luftën” kundër korrupsionit dhe emërimeve politike.

“Jemi të vendosur të luftojmë tregun e informalitetit. Janë licencuar rreth 51 agjenci që mundësojnë trajnimin profesional të mësuesve, por pa paragjykuar askënd do doja të ndaja me ju nevojën për të lexuar të vërtetat, të cilat shpesh janë denoncuar edhe nga media. Mësuesit vetëm se duhet të kenë disa kualifikime, i përfitojnë ato vetëm përmes pagesës pa ndodhur asnjë proces i marrjes së dijes. Ndaj ne po shkojmë drejt një politikë të re, atë të vlerësimit të nevojave për trajnimin për të gjithë mësuesit”, u shpreh ministria Nikolla.

Seminari “Edukimi global” në Shqipëri, si edhe seminarët e tjera të zhvilluar në vendet candidate të BE-së, kontribuojnë në zhvillimin e edukimit të zhvillimit global në vendet candidate, duke sjellë së bashku aktorët kryesorë të arsimit.

SPORTI NË SHKOLLA

Investim në masivizimin dhe cilësinë e sportit shqiptar



Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, ishte e pranishme në aktivitetin e organizuar në ambientet e palestrës së shkollës së “Kuçe”, me temë “Sporti në Shkolla: Investim në masivizimin dhe cilësinë e sportit shqiptar”.

“Duke investuar sot \$1 për sportin në moshë të hershme, nesër do të kemi kursyer \$3 për sistemin shëndetësor. Ndaj, sigurisht që shtimi i tre orëve të edukimit fizik, nuk do të mjaftojte që ne t’i përgjigjeshim cilësisë së shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve për secilin nga nxënësit e kësaj shkolle dhe ata kudo në Shqipëri. Pikërisht, platforma e Ministrisë së Arsimit dedikuar kësaj situatë të re, jo vetëm është e mirë ideuar, por ajo është edhe e mirë konsultuar me të gjithë specialistët e sportit, por dhe të shëndetit në vend. Ajo do të implementohet në të gjitha shkollat e Shqipërisë, çka do bëjë që ora e edukimit fizik të lidhet

me një jetë të shëndetshme për të gjithë nxënësit,” u shpreh Ministria Nikolla.

Ministrja e Arsimit, informoi se paralelisht, qeveria shqiptare ka investuar edhe në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së terreneve sportive, duke ndërtuar 44 të tilla në qytetet kryesore të vendit. Këto terrene sportive do të vihen jo vetëm në shërbim të nxënësve, por edhe të komuniteteve dhe prindërve në kuadër të projektit për kthimin e ambientit të shkollës në një qendër komunitare. Nëpërmjet bashkëpunimit shkollë-prindër-komunitet synohet një performancë për një jetë më të mirë e të shëndetshme, për më shumë edukim fizik, për më shumë aktivitete sportive.

Ndërkaq, Ministria Nikolla lançoi gjithashtu, nismën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për të themeluar Federatën Shqiptare të Sportit në Shkolla:

“Më lejoni t’ju bëj me dije një

lajm të mirë. Shumë shpejt ne finalizojmë ngritjen e Federatës Shqiptare të Sportit në Shkolla, që do të jetë një mundësi krejt e re jo vetëm për të na anëtarësuar në Federatën Evropiane të Sportit në Shkolla, e më pas në atë botërore, por ajo që është më e rëndësishme, për ta vendosur procesin e futjes së 3 orëve të edukimit fizik në të gjithë sistemin tonë parauniversitar, në një proces me baza shkencore dhe që shumë shpejt do të përkthehet në një situatë të re që lidhet me shëndetin në tërësi të të gjithë brezave,” u shpreh Ministria Nikolla.

Në drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, janë ngritur shoqatat sportive të shkollave në sistemin arsimor para-universitar, proces i cili do të vijojë me krijimin e kësaj Federate Kombëtare. Paralelisht, po krijohen kushtet për ngritjen edhe të Federatës së Sportit në Universitete, si pjesë e harmonizimit të reformave në të gjithë sistemin arsimor.

TË SHËNDETSHËM ME SPORT, TË USHQYER ME ART



Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Tiranë, zhvilloi në Stadiumin Kombëtar “Qemal Stafa” aktivitetin sportivo-artistik “Të shëndetshëm me sport, të ushqyer me art”, ku morën pjesë 5.000 fëmijë të 50 kopshteve të Tiranës.

Në aktivitet u përfshinë lojëra të shumëllojshme lëvizore spontane, popullore dhe sportive, të trajnuara dhe drejtuar nga mësues të edukimit

fizik dhe edukoret e kopshteve.

Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Rauf Dimraj në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se Ministria Arsimit dhe Sportit ka hartuar Platformën e Edukimit fiziko-sportiv dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse do të kontribuojë me seriozitet të plotë për përvetësimin dhe modelimin në praktikë të konceptit, që loja me lëvizje është aspekti më i rëndësishëm, më i dobishmi për edukimin e fëmijës.

Një numër i konsiderueshëm

fëmijësh, nën drejtimin e drejtuesve të kopshteve, pikturuan përgjatë zhvillimit të aktiviteteve lëvizore dhe ekspozuan pikturat e përfunduara. Në përfundim të këtyre aktiviteteve, fëmijët që performuan në aktivitete sportive dhe artistike, u vlerësuan me kupa dhe certifikata.

Në ceremoninë e mbylljes, çmimet u shpërndanë nga Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Z. Rauf Dimraj, Drejtoresha e Arsimit Parauniversitar në MAS, Zamira Gjini dhe drejtues të DAR Tiranë.

Intervista



Cilësia e kërkimit shkencor në Shqipëri ka pësuar rënie, botimet, periodikët shkencorë janë të pakta dhe, shpesh, mungon ballafaqimi i tyre me vendet e rajonit, të BE apo më gjerë

Geron KAMBERI

Drejtor i Përgjithshëm, AKTI

KËRKIMI SHKENCOR DUHET T’U PARAPRIJË ME IDETË E TIJ ZHVILLIMEVE NË FUSHA TË NDRYSHME

Kush është Geron Kamberi?
Jam lindur e rritur në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Histori-Filologjisë në vitin 1993, fillova punë si asistent kërkimor pranë Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë në Akademinë e Shkencave. Në këtë Institut punova nga viti 1993-1998 dhe kjo periudhë 5 – vjeçare ishte një eksperiencë interesante dhe mjaft vyer, megjithëse përkoi me një situatë të vështirë të kërkimit shkencor në Shqipëri si rezultat i tranzicionit social –ekonomik . Nga viti 1998 deri në vitin 2005 u angazhova në rolin e koordinatorit të programeve dhe menaxherit të projekteve të ndryshme të zhvillimit të arsimit, kulturës dhe bibliotekave pranë Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”. Nga viti

2005-2007, pasi ndoqa studimet pasuniversitare MA në Angli për Politikën Europiane pranë Institutit të Studimeve Europiane të Sussex-it, të Universitetit të Sussex-it, kam punuar në rolin e këshilltarit për politikën e advokacinë pranë organizatave ndërkombëtare si Oxfam GB- Albania dhe World Vision –Albania. Në të njëjtën kohë, nga 2007 e deri më tani, marr pjesë si bashkëpunëtor i jashtëm i disa think-tankeve në Shqipëri, në hartimin e një sërë studimesh dhe kam shkruar një sërë artikujsh në shtypin e përditshëm që lidhen me vlerësimin e politikave të integritit europian në Shqipëri. Në këtë drejtim eksperiencia ime profesionale është një kombinim mes aktiviteteve që lidhen me kërkimin, menaxhimin e projekteve të ndryshme, studimit të politikave dhe aspekteve të ndryshme të

çështjeve të integritit europian
Çdo të thotë të drejtosh një agjenci si AKTI?

Pasi ndoqa një procedurë konkurrimi nga ana e Departamentit të Administratës Publike për pozicionet e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND(në Prill 2015 u përzgjodha për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKTI-t. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë e Inovacionit, e cila njihet shpesh me akronimin e saj si AKTI, është një agjenci e cila është krijuar në vitin 2009 përmes VKM Nr 903 datë 26.08.2009 si një nga pikat e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillimin e Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit 2009-2015. Ajo është një agjenci me një histori relativisht të re ku përgjatë këtyre gjashtë viteve, është përpjekur të ndërtojë profilin e saj përmes programeve e mbështetjes të kërkimit shkencor në

Shqipëri, qoftë nëpërmjet financimit të Projekteve Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit (PKKZH), ashtu dhe përmes Projekteve të Bashkëpunimit Shkencor Dypalësh apo promovimit të Programeve kuadër të BE për kërkimin shkencor. Të drejtosh një agjenci si AKTI, do të thotë të lëvizësh në dy drejtime kryesore:

- Së pari, të arrish të administrosh në mënyrën e duhur e efektive fondet publike të buxhetit të shtetit për kërkimin shkencor që lëvrohen përmes thirrjeve të përvitshme për projekt-propozimeve ku aplikojnë studiues të fushave të ndryshme nga universitetet, apo institute kërkimore.

- Së dyti, të bësh të mundur njohjen, prezantimin dhe ngritjen e kapaciteteve mes kërkuesve shkencorë, lidhur në mënyrë që ata të marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë të suksesshme në të gjitha programet në kuadër të BE dhe iniciativat e ndryshme në nivel evropian e më gjerë (si p.sh, "Horizon 2020, COSME, Eureka) përsa i përket financimeve e mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor. Që prej Qershorit 2014, Shqipëria është vend kandidat për në BE, çka nënkupton që Shqipëria duhet të përshtatë një sërë politikash sektoriale që e përafrojnë atë me BE e që janë pjesë e Kapitullit 25 të acqui communautaire për Shkencën e Inovacionin dhe që do të bënin të mundur ndërveprimin, sa më efektiv të komunitetit shkencor shqiptar me Zonën e Përbashkët Europiane të Kërkimit Shkencor, apo siç njihet ERA (European Research Area)-in. Përgjatë viteve 2014-2020, BE ka objektiv strategjik të shndërrohet në një Bashkim apo Union të Inovacionit drejt një ekonomie që mbështet tek dija, duke nënkuptuar një rol parësor të financimit të kërkimit shkencor në nivel kombëtar deri në 3 % të GDP. Ky objektiv pasqyrohet edhe tek shuma prej

80 miliardë Euro që BE ka vënë në dispozicion të programit, kuadër të kërkimit shkencor e inovacion "Horizon 2020" për periudhën 2014-2020.

Cilat janë disa nga detyrat kryesore të AKTIT?

Detyrat e Agjencisë e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit janë të përcaktuara në VKM Nr 903 datë 26.08.2009 që bëri të mundur krijimin e kësaj agjencie në Shqipëria. Ato parashikojnë një sërë. Në bazë të këtij dokumenti ligjor që ka krijuar AKTI – ka për mision mbështetjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe të projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), në shkallë vendi. Gjatë zbatimit të këtij misioni, AKTI realizon detyrat e mëposhtme të tilla si:

1) Bashkëpunon me ministrinë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë së SHTI-së dhe promovon kërkimin në këtë fushë;

2) Realizon financimin e programeve dhe të projekteve të SHTI-së, në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe me vlerësimin e bërë nga komisionet përkatëse;

3) Harton dhe ndjek procedurat e aplikimit, të vlerësimit fillestar, monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar të programeve dhe projekteve të SHTI-së;

4) Krijon dhe pasuron, në mënyrë të vazhdueshme, bazën e të dhënave, të analizës dhe dokumentacionit të sistemit të SHTI-së;

5) Promovon, ofron ekspertizë, bashkërendon dhe monitoron bashkëpunimin dy dhe shumëplanësh me BE-në, vendet e veçanta dhe organizatat e huaja, në fushën e SHTI-së.

Nga pikëpamja e financimit të drejtpërdrejtë AKTI-ja është institucion buxhetor dhe financohet nga: a) Buxheti i Shtetit, në formë granti, zëri "Fondi për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (FSHTI)", nënënzërat mëposhtëm: i) Fondi për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit; ii) Fondi për infrastrukturën e kërkimit; iii) Fondi për qendrat e ekscelencës në kërkim; iv) Fondi për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin; v) Fondi për kërkuesit e rinj; vi) Fondi për programin Brain Gain. Duhet theksuar së deri më tani gjatë periudhës 2010-2014 për shkak të



buxhetit të pamjaftueshëm AKTI ka përfituar vetëm nga Fondi për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit ku është hapur vetëm një Thirrje për Projektet Kombëtare në Kërkim –Zhvillimit në vitin 2010 dhe përgjatë viteve në vazhdim, buxheti ka qenë për vazhdimin e financimit të fazave të këtyre projekteve të miratuar në vitin 2010. Njëkohësisht AKTI gjatë kësaj periudhe ka arritur të përfitojë fonde e financime nga donator të ndryshëm, përmes projekteve të ndryshme ku ka qenë në rolin e partnerit apo koordinatorit kombëtar

Ku janë mangësitë e kërkimit shkencor në Shqipëri?

Kërkimi shkencor në Shqipëri realizohet në një sërë institucionesh të cilat u përkasin 3 grupeve kryesore:

Së pari, janë departamentet e ndryshme në fakultet e universiteteve publike e jopublike në Shqipëri;

Së dyti, është Qendra e Studimeve Albanologjike që grupon një sërë institutesh të shkencave albanologjike;

Së treti, janë institute , qendra

apo agjenci që janë në vartësi të ministrive të linjës. Nga ana tjetër që prej pas viteve 90 në Shqipëri ka filluar të konsolidohet sektori i organizatave të tipit think-tank që përpiqen të ofrojnë kontributin e tyre në fushën e kërkimit kryesisht përmes studimeve që lidhen me analizat e politikave sektoriale, apo aspekteve të ndryshme të zhvillimit në Shqipëri. Kërkimi shkencor në Shqipëri përjetoj një tranzicion të vështirë social-ekonomik pas viteve 90, për shkak të mungesës së financimeve për këtë fushë, si rezultat i vështirësive ekonomike që shoqëruan dhe ende vazhdojnë të shoqërojnë tranzicionin e vendit. Kjo solli si pasojë fenomenin tashmë të njohur të “brain drain-it”- në një sërë universitetesh dhe institucionesh kërkimore duke cenuar kapacitetin e burimeve njerëzore të kërkimit shkencor. Nga ana tjetër, komuniteti i kërkuesve shkencorë në Shqipëri ndjehet i shkëputur, veçanërisht, nga biznesi dhe binomi shkencë-biznes që, në vende të tjera është i fortë, në Shqipëri është ende i papërfillshëm. Infrastruktura e kërkimit shkencor ku përfshihen

laboratorët e biblioteka shkencore, ende mbetet e dobët dhe me mangësi të dukshme, pavarësisht një sërë ndërhyrjesh që janë bërë nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj. Statusi i studiuesit, apo kërkuesit shkencor si një zë me autoritet publik në fusha të caktuara, është akoma i pafuqishëm. Nga ana tjetër, cilësia e kërkimit shkencor në Shqipëri ka pësuar rënie, botimet, periodikët shkencorë janë të pakta dhe, shpesh, mungon ballafaqimi i tyre me vendet e rajonit, të BE apo më gjerë. Përtej këtyre mangësive, gjithsesi, ka përpjekje të vazhdueshme nga studiues, apo institucione të veçanta që të kapërcejnë vështirësitë që ndeshen. Kërkimi shkencor nuk mund të shihet i shkëputur nga ecuria e sektorëve të tjerë në vend por, ndërkohë, është e vërtetë, që ai duhet t’u paraprijë me idetë e rrugëzgjdhjet e tij zhvillimeve në fusha të ndryshme .

Cili është opinionin juaj për Ligjin e ri të Arsimit të Lartë?

Në ligjërimin publik shpesh Ligji Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet



e Arsimit të Lartë” përmendet përgjysmë dhe duket sikur nga grupet e interesit harrohet me “qëllim” apo “pa qëllim” pjesa e ligjit që lidhet me kërkimin shkencor. Deri diku kjo është një pasqyrim i nivelit ende të ulët të kërkimit shkencor, brenda institucioneve tona akademike, ku mbingarkesa e mësimdhënies duket sikur e ka vënë “përfund” kërkimin shkencor. Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë, përcakton kuadrin e përgjithshëm ligjor mbi të cilën do të ndërtohet funksioni dhe ecuria e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe mekanizmat institucionalë. Sfida kryesore mbetet zbatimi i tij përballë kundërshtive që ka hasur dhe, veçanërisht, plotësimi sa më parë i akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur funksionimin e zbatimit e tij praktik, duke patur parasysh ato risi, apo ndryshime që mbart në raport me ligjin e mëparshëm

Me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë, Agjencia kaloi në varësi të MAS. Çfarë ka ndryshuar dhe çdo të sjelli kjo?

Në Nenin 12 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, theksohet se krijohet Agjencia Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit –AKKSHI që nënkupton shndërrimin e Agjencisë Kërkimit, Teknologjisë e Inovacionit në agjencinë e sipërpërmendur. Sipas këtij Neni, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), është institucion publik në varësi të Ministrisë, përgjegjëse për arsimin dhe shkencën, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të kërkimit shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane. Nga ana

tjetër, ligji përcakton se AKKSHI-ja identifikon fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe vlerëson në nivel kombëtar programet e projektet në fushat e sipërpërmendura dhe është përgjegjëse për përhapjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor në arsimin e lartë. Sipas përcaktimeve në këtë ligji, AKKSHI-ja organizon çdo katër vjet procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe i rendit ato në bazë të këtij vlerësim duke ia komunikuar këtë vlerësimin Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë –AKFAL. Nga ana tjetër, AKKSHI-ja miraton, mbi bazën e konkurrencës së lirë midis aplikantëve, fonde për projektet e studimeve të doktoratës dhe administron edhe fonde të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare dhe dypalëshe të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e institucioneve. AKKSHI do të drejtohet nga Bordi i Administrimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të këtij bordi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu në bazë të Neni 13 të këtij ligji, është parashikuar që AKKSHI të administrojë e përditësojë “Bazën kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor”. Baza kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor përfshin: a) listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht; b) listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit European: anglisht, frëngjisht,

gjermanisht, spanjisht, italisht c) listën e përditësuar të kontributit shkencor të personelit akademik e kërkimor të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe të personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkim-zhvillimit d) administron dhe bën publike bazën e të dhënave me të gjitha projektet e financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit. Kalimi në vartësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, është një mundësi më shumë për të qenë të lidhur më nga afër me problematikat dhe ofrimin e propozimeve e rrugëzgjdhjeve më konkrete, në dobi të forcimit të kapaciteteve e kërkimit shkencor në vend

Disa waktivitete që ka bërë AKTI

Gjatë këtyre muajve Agjencia e Kërkimit , Teknologjisë e Inovacionit është përfshirë në një sërë aktivitete. Një nga aktivitetet më të rëndësishme ishte lancimi më 16 Tetor i hapjes së Thirrjes për Projekteve Kërkimore Kombëtare në fushën e ICT që do të ofrojnë zgjidhje në fusha të tilla si mjedisi, energjia, shëndetësia, shkencat sociale, bujqësia. Në këtë aktivitet që u organizua me mbështetjen e Ministres së Shtetit për Inovacionin e Administratën Publike znj, Milena Harito, u theksua rëndësia e përfshirjes së komunitetit të kërkuesve e pedagogëve të fushës së ICT në këtë proces. Ndërkohë Gjatë këtyre, AKTI ka organizuar rreth 30 dite informative në institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore-shkencor publike dhe jopublike ,lidhur me Programin Kuadër të BE për Kërkim Shkencor e Inovacion “Horizon 2020”. Dua të theksoj, se Shqipëria i është bashkuar dy vitet e fundit rrjetit “Euraxess”. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti, është të sigurojë asistencë të personalizuar për studiuesit dhe kërkuesit shkencorë, që lëvizin nga

një vend në tjetrin, për të zhvilluar karrierën e tyre akademike e kërkimore-shkencore. Nga ana tjetër, ky rrjet i ngritur në këto 40 vende, synon të promovojë “Strategjinë Europiane të Burimeve Njerëzore në fushën e Kërkimit Shkencor”, “Kartën Europiane për Kërkuesit Shkencorë ” si edhe “Kodin e Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve”. Gjithashtu, “EURAXESS” ofron informacione mbi bashkëpunimet ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor dhe politikave europiane në këtë fushë dhe, sesi ato ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të çdo vendi. Në këtë kuadër, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit-AKTI, si koordinator kombëtar i këtij rrjeti, ka filluar punën për ngritjen e Rrjetit “EURAXESS Albania” përmes zbatimit të projektit “ALBANIAN EURAXESS Service Netëork”, AL-ES -Net që u financua nga Komisioni Europian, nëpërmjet Programit të Shtatë Kuadër të BE për Kërkimin Shkencor e Inovacionin FP7 (2007-2013). Kohëzgjatja e këtij projekti është 3 (tre) vjet, 1 Tetor 2013 – 30 Shtator 2016. Nëpërmjet këtij rrjeti, tashmë të gjithë studiuesit shqiptarë kanë një mundësi të marrin informacion profesional dhe personal lidhur me hapësirat

konkrete që ofrojnë institucione të ndryshme universitare e qendra kërkimore shkencore të vendeve të tjera për punësim në fushën e kërkimit e mësimdhënies akademike. Duhet të theksojmë se komuniteti i kërkuesve shkencorë është në hapat e parë të njohjes e familjarizimit me këtë proces që nuk ofron vetëm mundësi informimi mbi hapësirat e punësimit në institucionet akademike e kërkimore shkencore të vendeve të ndryshme. Nëpërmjet tij, secili studiues mund të gjejë informacion edhe mbi mundësitë e financimit të projekteve kërkimore –shkencore, veçanërisht, grantet individuale siç janë: Grantet e Këshillit Europian për Kërkim Shkencor (angl. ERC Grant(European Research Grants) dhe Aktivitetet Marie Sklodow ska Curie (angl. MSC actions). Nga ana tjetër, në rast përfitimi të një mundësie punësimi zyrtar “Euraxess” të atij vendi, i ofrojnë falas studiuesit një sërë informacionesh të vlefshme praktike për strehimin, sistemin e siguracionit shëndetësor e social, shkollimin e fëmijëve. Të njëjtën funksion kryen në këtë rast edhe Rrjeti “Euraxess -Albania” për studiuesit e huaj që mund të punësohen në Shqipëri përmes këtij portali. Në 7 Maj 2015 u organizua Trajnimi dhe Workshop-

in “Promovimi i Rrjetit EURAXESS në Shqipëri” ku ishin të pranishëm rreth 100 pjesëmarrës . Këtë vit për herë të parë në Shqipëri u organizua aktiviteti “Euraxess on tour 2015” .Ky ishte një aktivitet interesant ku Autobusi EURAXESS – në Udhëtim (angl. EURAXESS - on tour) ndaloi në datën 15 tetor 2015 në Universitetin e Shkodrës dhe në datën 16 tetor 2015 para godinës së Universitetit Politeknik në Tiranë. I nisur nga Brukseli, më datë 5 tetor 2015, ai vizitoi dy qytete në Shqipëri, Shkodrën dhe Tiranën, dhe udhëtimi i tij i plotë përfshiu 34 qytete evropiane dhe 16 vende të përfshira në projektin e rrjetit “EURAXESS”. Kjo ishte një nismë e Komisionit Europian në kuadër të projektit “EURAXESS”. Kërkimi Shkencor në Lëvizje (angl.»EURAXESS-Research In Motion») i cili u drejtohet studentëve dhe studiuesve të rinj, duke i informuar ata për mundësitë e financimit, mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës personale. Ky aktivitet u ofroi studentëve e pedagogëve pjesëmarrës këshilla për përmirësimin e CV-së akademike, mundësinë për të realizuar foto profesionale për CV-të e tyre dhe zhvillimin e një workshopi në secilin qytet ku u trajtuan një sërë tematikash në kuadër të Programit “EURAXESS”.





SHQIPËRIA, PJESË E RRJETIT “EURAXESS”

Rajna SPAHO
Specialiste AKTI

Komuniteti Kërkimor Shkencor në Shqipëri tashmë ka një mundësi më shumë për të zhvilluar dhe përmirësuar karrierën kërkimore.

Që prej vitit 2014 Shqipëria është zyrtarisht pjesë e Rrjetit Euraxess.

Euraxess është një iniciativë unike mbarë-europiane, e cila jep informacione dhe shërbime mbështetëse për kërkuesit shkencorë profesionist. E përkrahur nga Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare, ajo synon të mbështesë mobilitetin e kërkuesve shkencorë dhe zhvillimin e karrierës së tyre, ndërsa nxit rritjen e bashkëpunimit shkencor midis Europës dhe Botës.

Euraxess gjithashtu promovon Kartën dhe Kodin Europian, që parashikon të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve, punëdhënësve dhe financuesve të kërkimit. Qëllimi është përmirësimi i kushteve të punës për kërkuesit shkencorë dhe siguria që

ata të marrin të njëjtin trajtim kudo që ata punojnë në Europë.

Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit si një institucion juridik publik nën varësinë e Kryeministrit me mision mbështetjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe të projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit për t'i ardhur në ndihmë komunitetit kërkimor shkencor ka marrë përsipër ngritjen e Rrjetit Euraxess në Shqipëri.

Në kuadër të kësaj nisme në datat 15-16 Tetor 2015 në Shqipëri u organizua për herë të parë aktiviteti “Euraxess on tour 2015”. Për herë të parë në dy qytete Shqiptare përkatësisht Shkodër dhe Tiranë ndaloi Autobusi Euraxess.

Kjo ndalesë është pjesë e një turneu 2 mujor të Programit EURAXESS financuar nga Bashkimi Europian - gjatë së cilit vizitohen 34 qytete në 16 vende Europiane. Autobusi EURAXESS i ofron studentëve dhe kërkuesve

qasje të drejtpërdrejta te shërbimet të ofruara nga EURAXESS.

Autobusi EURAXESS – Researchers in Motion (Studiuesit në Lëvizje) mbërriti në **15 Tetor 2015 në Shkodër dhe 16 Tetor 2015 në Tiranë**, me informacion rreth punëve kërkimore dhe mundësive për financim. Studentët dhe kërkuesit shkencorë ishin të ftuar të na vizitonin nga ora 10.00 – 15.00 për të zbuluar se si të gjejnë punë në vende të tjera Europiane dhe të marrin financime.

Autobusi ndërveprues përmbante terminale informacioni ku kërkuesit shkencorë mund të përdornin faqen e internetit EURAXESS dhe të postonin jetëshkrimet e tyre. Profesionistët e EURAXESS ishin të gatshëm të shpjegonin shërbimet që ofron Programi Euraxess dhe si mund të përdoren këto shërbime për të gjetur punë dhe filluar karrierën kërkimore shkencore. Një fotograf profesionist iu bëri vizitorëve fotografi jetëshkrimi profesioniste falas.



Fakte dhe shifra

- EURAXESS mbështetet nga 40 vende pjesëmarrëse në të gjithë Europën.

530 anëtarë personeli të EURAXESS, në 260 qendra shërbimi ofrojnë ndihmë të personalizuar. Ndërsa faqja e internetit ofron një pikë të vetme qasjeje për informacion në të gjitha vendet.

- Mbi 900,000 kërkesave kanë marrë përgjigje nga Euraxess deri më sot. Këto kërkesa janë rreth mundësive për punë dhe financim, vizave dhe kushteve për hyrje, akomodimit, shkollave, problemeve ligjore dhe siguracioneve për mobilitetin e kërkuesve.

- Faqja e internetit EURAXESS ka parë tashmë një rritje të qëndrueshme të vizitorëve. Në vitin 2015 pati gati 1,900,000 vizitorë dhe afërsisht 6,8 milion vizita të faqeve Euraxess në gjithë rrjetin.

- Në vitin 2015 u publikuan më shumë se 42,000 lajmërimet për punë.

- Mbi 8,300 organizata, kompani, universitete dhe sipërmarrje të vogla e të mesme janë regjistruar në portalin EURAXESS Jobs. 16,000 studiues ofrojnë jetëshkrimet e tyre për punëdhënës të mundshëm dhe janë regjistruar 35,500 studiues.

Programi Euraxess në Shqipëri mbështetet nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit që prej vitit 2014, duke i ofruar kërkuesve Shqiptar një portal tërësisht Shqip për Programin Euraxess dhe duke i mbështetur në zhvillimin e një karrierë profesionale në fushat e tyre të kërkimit shkencorë.

Për më shumë informacion

- EURAXESS: www.euraxess.org
- Euraxess Albania: www.euraxess.al
- EURAXESS në turne: www.facebook.com/EURAXESS.OnTour
- Tëitter: @EURAXESS_OnTour
- European Research Area (ERA): http://ec.europa.eu/research/era/index_en.htm
- Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit: www.akti.gov.al



CILAT JANË DEGËT E PREFERUARA NË UNIVERSITETE?



Prof. Dr. Engjëll PERE
UET

Ky trajtim mund të marrë një interesim më specifik në kuadrin e ligjit të ri mbi organizimin e arsimit të lartë, në të cilin një aspekt me mjaft inters është edhe ai diferencimit të mbështetjes publike për degë apo profile të veçanta, ndoshta më pak të kërkuara nga individit, por mjaft të rëndësishme për zhvillimin shoqëror në tërësi

Më prag të fillimit të vitit akademik 2015-2016, ashtu sikurse në çdo vit, me interes është edhe analiza e studimit të prirjeve të studentëve në zgjedhjet e tyre për studimet në degë apo profile të ndryshme të shkollës së lartë. Kjo analizë do t'i shërbente njohjes së interesave të të rinjve për degët e tyre më (pak) të preferuara, cilët janë profilet më shumë apo më pak të kërkuara, cilët janë degët në të cilat "tërheqin" studentët më të mirë, etj. dhe në këtë kuptim edhe orientimit të politikave apo strategjive të zhvillimit të arsimit të lartë në vendin tonë. Në veçanti ky trajtim mund të marrë një interesim më specifik në kuadrin e ligjit të ri mbi organizimin e arsimit të lartë, në të cilin ndër të tjera një aspekt me mjaft inters është edhe ai diferencimit të mbështetjes publike për degë apo profile të veçanta, ndoshta më pak të kërkuara nga individit, por mjaft të rëndësishme për zhvillimin shoqëror në tërësi.

Njëkohësisht, kjo analizë mund të ishte e vlefshme edhe për një gjykim më specifik për funksionimin, arritjet, apo edhe mangësitë e maturës shtetërore, për të cilën viti akademik 2014 – 2015, sipas të gjitha gjasave do të jetë viti i fundit.

Në këtë këndvështrim, në këtë shkrim jam përpjekur të bëj një analizë të përgjithshme mbi preferencat në zgjedhjen e degëve apo profileve të ndryshme në shkollat e larta nisur nga dinamika e tyre në këto 5 - 6 vjetët e fundit. Kështu në këtë trajtim janë marrë rezultatet e studentëve fitues për disa degë, (në këndvështrimin personal më domethënëse), duke filluar nga viti akademik 2010 - 2011 deri në atë aktual 2015 – 2016. Konkretisht vlerësimi është përqëndruar në katër universitete të rëndësishme të sistemit tonë arsimor, si Universiteti i Tiranës (UT), Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), Universiteti Mjekësor i Tiranës (UMT) dhe ai Bujqësor i Tiranës (UBT). Degët e përzgjedhura janë gjithsej 19, ndër

të cilat 6 degë nga më të kërkuarat: si Mjekesi e Përgjithëshme dhe Stomatologji (UMT), Informatikë Ekonomike dhe Financë (UT), si dhe Inxhinieri Elektronike dhe Inxhinieri Informatike (UPT); 8 degë të tjera janë jo shumë të preferuara (në 2010-tën): si Mbrojtje Bimësh dhe Prodhim Bimor (UBT), Inxhinieri Hidroteknike dhe Inxhinieri Mekanike (UPT), si dhe degë të "vështira" si Matematikë, Kimi, Fizikë dhe Biologji (UT). Gjithashtu janë analizuar preferencat edhe për 5 degë të tjera me nivel përzgjedhje mesatar, nisur kjo kryesisht nga niveli i pikëve në vitin 2010, si: Shkenca Politike, Gazetari, Teknologji informacioni, dhe Informatikë (UT), si dhe Inxhinieri Ekonomike (UPT).

Me gjithëse mjaft e përgjithëshme, analiza e përdorur për gjykimin mbi ndryshimin e preferencave për këto degë, është bazuar në të ashtuquajturin pikët e "fituesit të fundit" (sipas degëve përkatëse).

Kjo analizë pikë së pari, evidenton faktin e njohur për rritjen graduale të pikëve të fituara nga maturantët. Kështu për të 19 degët, rritja mesatare e pikëve të “fituesit të fundit”, sipas viteve, ka qënë 110 – 180 pikë më shumë se viti paraardhës. Karakteristikë është se rritja është më e madhe kryesisht për degët më pak të preferuara si Matematikë, Fizikë dhe Mbrojtje Bimësh. Ndërsa ky tregues ka qëndruar pothuajse konstant në degën e Gazetarisë dhe ka rënë në atë të Shkencave Sociale. Rritja e pikëve, në vështrim të parë duket si diçka positive, pasi ajo mund të dëshmojë për rritjen e nivelit cilësor të maturantëve, por njëkohësisht ajo mund të flasë edhe për një “tolerancë” graduale në rritje të vlerësimit nga matura shtetërore.

Më tej, analiza e rezultateve tregon se degët më të preferuara në vitin 2015, sipas renditjes janë: Mjekësia e Përgjithshme, Stomatologji, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike dhe Informatikë Ekonomike. Mjekësia e Përgjithshme dhe Stomatologjia në fakt kanë qënë gjatë gjithë viteve të analizuar degët më të preferuara, por vlen të theksojmë se preferencat kanë ndryshuar për degët e tjera, kështu në 2010, pas degëve të

mjekësisë ishin ato të Informatikës ekonomike dhe e Financës, ndërsa pas vitit 2012 – 2013, më të preferuara se këto degë ishin ato të Inxhinierisë Informatike dhe Inxhinieri Elektronike.

Në ekstremin tjetër, janë degët e Kimisë, Inxhinierisë Mekanike, Fizikës, Mbrojtje Bimësh dhe në fund Prodhim Bimor, renditje e cila nuk ka ndryshuar për të gjithë periudhën 2010 – 2015. Sigurisht, ky pozicionim i degëve të tilla, si Kimi, Fizikë apo edhe Inxhinierisë Mekanike është shqetësues jo vetëm për faktin e nivelit e studentëve që ato kërkojnë realisht si degë të shkencave ekzakte, por edhe pasi ato përbëjnë realisht shtylla të rëndësishme të përgatitjes së maturantëve të rinj. Nga ana tjetër, karakteristikë positive paraqet dega e Matematikës, e cila në vitin 2015 renditet e 7-ta, (menjëherë pas degës së Financës), nga e 14-ta që ishte në vitin 2010. Vlen të theksohet se rritja e preferencës për këtë degë ka qënë e konsiderueshme e në vazhdimësi për të gjithë periudhën. Ndryshe nga Fizika apo Kimia, kjo degë mund të mos konsiderohet më si “jo e preferuar”. E tillë mund të mos konsiderohet edhe një degë tjetër e shkencave të natyrës, si Biologjia, e cila pamvarësisht nga renditja, vitet e fundit ka marrë pikë

mjaft të përafërta me degë të tilla të kërkuara si Teknologji informacioni apo Informatikë.

Përsa i takon degëve të konsideruara të nivelit “mesatar”, nga pikpamja e pikëve për të fituar të drejtën e studimit në to, të dhënat tregojnë se dega e Gazetarisë dhe Shkencave Sociale kanë pësuar një rënie në renditje, duke zënë vendin e 13-të dhe 14-të në 2015, (ndaj 19 degëve të studiuar), ndërsa përkatësisht e 7-ta dhe e 8-ta në 2010 renditeshin. Në këtë grup bën përshtypje dega relativisht e re e Inxhinierisë Ekonomike, duke u renditur e 8-ta (në 19 degë), ku niveli i pikëve të fituesit të fundit, në vitet e fundit ka qënë mbi 6.000 pikë, duke u diferencuar konsiderueshëm nga degët e tjera që vinë më pas. Vlen të theksohet, se nje profil i tillë, është i kërkuar sot edhe në curriculat e universiteteve të huaja.

Në tërësi mund të vlerësohet, se ndryshimi i strukturës së preferencave të maturantëve, ka prirje drejt degëve, apo profesioneve, të cilat kërkojnë një nivel dijes më teknike. Megjithëse kjo prirje mund të jëtë me ritme jo shumë të dallueshme, apo signifikative, personalisht mendoj se kjo duhet konsideruar si një tendencë positive.



STOP DHUNËS NË INSTITUCIONET SHKOLLORE



Shqiponja LAMÇE

MAS

Më përmbushje të politikave të saj arsimore për përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë dhe sigurimin e mirëqenies fizike, sociale dhe emocionale për çdo nxënës, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka ndërmarrë nismën “Stop dhunës në shkollë”. Kjo nismë duhet konsideruar si një aksion kombëtar i koordinuar që nxit angazhimin e shkollës, familjeve, komunitetit, institucioneve shtetërore dhe organizatave civile për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në shkollë, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, zgjidhjen paqësore të konflikteve.

Dhuna në shkollë është një shqetësim i përgjithshëm i shoqërisë që ndikon më së pari nxënësit, të rinjtë, arrijtet e tyre akademike dhe cilësinë e jetës në shkollë. Edukimi për parandalimin

e dhunës dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve i ndihmon nxënësit, mësuesit, prindërit dhe komunitetin më të gjerë të përcjellin frymën e dialogut, tolerancës, mirëkuptimit e solidaritetit.

Legjislacioni shqiptar, Kushtetuta e Shqipërisë, Konventa e të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara e ratifikuar nga Shqipëria, Ligji për Arsimin Parauniversitar si dhe dokumente të tjerë strategjikë mbështesin dhe sigurojnë bazën ligjore për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjve, në shkollë dhe jashtë saj.

Parandalimi dhe lufta ndaj dhunës në shkollë kërkon ndërhyrje periodike dhe një qasje të përbashkët të strukturuar të organizmave e institucioneve që lidhen dhe mund të kontribuojnë në përmirësimin e jetës në shkollë. Shkollat vetëm nuk

mund t'i përgjigjen manifestimeve të ndryshme të dhunës në shkollë e komunitet. Ato duhet të ndërtojnë e forcojnë bashkëpunimin me familjet, partnerët e ndryshëm dhe komunitetin.

Kështu MAS ne bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere si CRCA, Terre des Home, UNICEF, Femijet Sot, Ëorld Vision, AFCD, Save the Children, ka hartuar një plan kombëtar veprimi duke marrë në konsideratë iniciativat e ndërmarra deri më tani dhe përvojat që shkollat tashmë kanë krijuar në menaxhimin e rasteve të dhunës.

Ne kuadër nismes “Stop dhunës në shkollë”, ne 2 tetor 2015, me rastin e ditës nderkombetare kundër dhunës, në të gjitha shkollat e vendit u zhvilluan aktivitetet të larmishme.

Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës, sipas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të datës

15 qershor 2007, festohet çdo vit më 2 tetor, ditëlindjen e Mahatma Gandhi. Kjo datë reflekton respektin universal që Gandhi ka frymëzuar dhe forcën dhe rëndësinë e filozofisë së tij. Me anë të filozofisë së tij të jo-dhunës ai hedh poshtë mendimin se ndryshimet politike apo sociale mund të ndodhin nëpërmjet përdorimit të forcës dhe mbështet idenë se njerëzit të cilët ngrenë krye ndaj mposhtjes mund të ndryshojnë gjendjen e tyre duke gjetur mënyra efektive për të arritur ndryshimin e kërkuar.

Gjithashtu kanë filluar përgatitjet për aktivitet e shtrira në të gjithë vendin me rastin e 20


nëntorit Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve.

Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, festohet çdo vit më 20 nëntor, ditë në të cilën është shpallur Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo Konventë erdhi pas një revolucioni të thellë në mendimin e të rriturve lidhur me fëmijët- ata nuk konsiderohen si "pronë " e të rriturve, as si zgjatim i prindërve, por si individë të pavarur me të drejta të plota. Ratifikimi i konventës në vitin 1992 nga Shqipëria shërbeu si një gur themeli për ndërtimin e vlerave demokratike dhe në trajtimin e fëmijëve si

qytetarë me të drejta të plota.

Gjithashtu filloi faza e dytë e projektit KOMBI, i cili sjell në vëmendje rëndësinë e përdorimit të mënyrave të reja të disiplinimit, si mënyrë efikase për menaxhimin e sjelljeve të dhunshme dhe eliminimin e çdo forme të dhunës ndaj fëmijëve në shkollë.

Ky program kërkon të tërheqë vëmendjen mbi rregullat dhe procedurat që do të zbatohen në hetimin e incidencave të rasteve dhe penalteteve ndaj mësuesve që ushtrojnë dhunë ndaj nxënësve në shkollë. Ky program realizohet nga MAS, UNICEF dhe Fëmijët Sot.





EMËRIMET E MËSUESËVE PËRBALLË SFIDAVE TË KONKURRENCËS

Shkëlqim Allkaj

Drejtor DAR Qarku Fier

Ka kohë, të paktën këto 20 vitet e fundit, që sistemi arsimor parauniversitar në vendin tonë, ka pësuar ndryshime dhe ka nxjerr në pah problematika të shumta. Janë bërë ndryshime të herë pas hershme të kurrikulave, kornizave kurrikulare, standardeve të mësuesëve dhe drejtuesëve të shkollave, strukturës së cilëve të studimit, ndryshime të planeve mësimore (lëndëve që zhvillojnë nxënësit), zhvillimi i maturës shtetërore etj. Të gjitha këto ndryshime perceptohen në mënyrë sekondare nga opinion publik, pasi janë teknike dhe mund të konceptohen qartësisht vetëm nga ekspertët të arsimit.

Ajo që duket si drita e diellit dhe bie në sy të të gjithë prindërve, nxënësve, por edhe të opinionit publik, është puna dhe personaliteti i mësuesit. Jemi të vetëdijshëm që post viteve '90 në sitemin tonë arsimor u përfshinë

për nevoja emergjente të shkollave mësues me arsim të mesëm apo dhe me arsim të lartë jo mësuesi. Por, krahas këtyre kategorive u përfshinë mësues, niveli pedagogjik dhe shkencor i të cilëve ishte dëshpërues. Është pranuar tashmë si opinion i ngulitur shoqëror, që niveli dhe sjellja e mësuesëve në auditore është jo e mirë dhe herë – herë e papranueshme. Përballë këtij ekzaminimi pathologjik të gjendjes së mësimdhënies dhe rolit edukativ të mësuesëve në shkolla, MAS, prej afro një viti, ka ndërmarrë nisma të rëndësishme dhe të pritura nga të gjithë prindrit dhe nxënësit, por edhe mësuesit dinjitozë dhe profesionistë, për të zgjidhur një herë e përgjithmonë këtë situatë të cilësisë së mësuesëve në shkolla. Një nga risitë është emërimi i mësuesëve nëpërmjet testimit, një politikë arsimore e shprehur së fundmi edhe në udhëzimin nr 38, dt 6.10.2015 të MAS “Për emërimin dhe largimin nga puna të mësuesëve në

arsimin parauniversitar”. Nëse do të bënim një analizë të “frymës” që kërkon të përcjell ky udhëzim për të gjitha emërimet e reja në arsim, padyshim që do të konvergonte me parimet e meritës, transparencës, ndershmërisë, fuqizimit të rolit të prindërve në emërimet, vëmendjes ndaj gjendjes psikologjike dhe personalitetit të çdo mësuesi. Me qëllim që tju krijojë lexuesëve dhe gjithë të interesuarëve për punësimet dhe largimet nga puna të mësuesëve, po jap një përshkrim mbi pesë boshtet kryesore të politikave të punësimit mbi të cilat është ndërtuar ky udhëzim.

1. Punësim sipas meritës.

Punësimi i çdo mësuesi do të bëhet vetëm nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe testimit për njohuri shkencore dhe pedagogjike. MAS është kujdesur që pikëzimi i dosjeve të bëhet vetëm për ato të dhëna që krijojnë personalitetin intelektual të mësuesit dhe përbëjnë bërthamën e zhvillimit

profesional të mësimdhënies siç janë: cilësia e arsimit të lartë, përvoja si mësimdhënës, studimet pasuniversitare dhe gradat shkencore në fushën bazë, kualifikimi 5, 10 dhe 20 vjeçar, njohja e gjuhëve të huaja, botimet shkencore etj. Nga udhëzimet e mëparshme janë shmangur kërkesa të panevojshme dhe fiktive që shtonin pikë artificialisht në dosjet e mësuesëve. Një zë tjetër që plotëson vlerësimin përfundimtar të mësuesit është testimi i organizuar nga MAS për të marrë një fedback mbi nivelin e dijeve të fituara gjatë arsimit të lartë të kandidatëve për mësues, por mbi të gjitha për të bërë dallimin e cilësisë.

2. Emërime transparente.

Tashmë emërimet do të bëhen publike nga një komision ad-hoc i përbërë nga mësues, prindër, përfaqësues të drejtorisë arsimore, të shërbimit psiko-social dhe të ftuar nga sindikatat, pushteti vendor etj. Detyra e komisionit fokusohet në procesin e vlerësimit të dosjeve të çdo kandidati për mësues dhe renditjen përfundimtare sipas profileve, duke mbledhur pikët e dosjeve plus piket e fituara nga testi shkencor. Kjo renditje shpallet publikisht dhe vetëm në bazë të kësaj renditje do të krijohet mundësia e punësimit. Kjo risi emërimesh për herë të parë e zbatuar në vendin tone, siguron që pranë nxënësve të shkojnë mësuesit më cilësor të mundshëm, shmang çdo ndërhyrje jashtëmësimore, largon përfundimisht politikën nga shkolla dhe mbi të gjitha rrit besimin e nxënësve dhe prindërve të mësuesi, duke i kthyer mësuesëve dhe shkollave dinjitetin e domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të ketë kurrë sukses.

3. Fuqizim të rolit të prindërve

. Në të gjitha zhvillimet arsimore të viteve të fundit që nga viti 2012, kur u miratua ligji për arsimin parauniversitar me shumicë të

cilësuar në parlament, është kërkuar që prindrit të kishin rol aktiv në jetën shkollore. Kjo tendencë është realizuar modestisht, por ka patur edhe problematikat apo moskuptime nga drejtues apo edhe prindër. Tashmë prindrit gjenden të përfshirë në të gjitha rastet. Ata kanë zërin e tyre në komisionin që do të ngrihet në drejtoritë apo zyrat arsimore me dy anëtarë. Prindërt gjithashtu kanë 1/3 e pikëve në vlerësimin e performancës publike, që mësuesi ka krijuar në shkollat ku punon. Ata janë aktorë dhe kanë të drejtë të marrin nisma për largimin nga shkolla të mësuesëve, që nuk realizojnë aspiratat për cilësinë që ata kërkojnë përfëmijën e tyre. Pësia e zërit të prindërve ka rolin e vetë edhe në rastet e largimit nga puna të mësuesëve, që nuk japin lëndë për të cilat janë diplomuar. Gjithë kjo qasje ligjore është bërë me vetëdije të plotë për rolin që kanë prindërit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në shkolla.

4. Vlerësim i gjendjes psikologjike dhe personalitetit të çdo mësuesi. Për herë të parë vlerësimi psikologjik i mësuesit merr peshë në pikëzimin e përgjithshëm të mësuesëve. Ka patur raste të izoluara që nxënësit tanë janë përballur me mësues arrogant, depresiv, me personalitet të deformuar, pedofil, të korruptuar, të dhunshëm, ironik etj. Në këtë udhëzim MAS i ka kushtuar vëmendje kësaj çështje mjaft delikate dhe me pasoja të parikuperueshme për "viktimat" e këtyre pseudomësuesëve, por edhe për figurën e mësuesit në tërësi si dhe besimin e shoqërisë ndaj shkollës. Udhëzimi u jep mundësi psikologëve, që nëpërmjet metodave profesionale dhe pyetësorëve psikologjik të bëjnë vlerësimin me pikë për mësuesit, sa herë që do tju kërkohet nga drejtoritë arsimore apo drejtoritë e shkollave.

5. Mësuesit në detyrë. Një fokus tjetër shumë i rëndësishëm, i qëllimit ligjor të këtij udhëzimi është përcaktimi i të gjitha shkaqeve dhe procedurave që e detyrojnë një mësues të humbas vendin e punës. Për herë të parë vendoset që një mësues largohet nga puna nëse nuk jep mësim sipas diplomimit që ka. Kjo fjali e vënë në këtë udhëzim, bënë që nxënësit të mësohen për çdo lëndë dhe për çdo orë të kenë mësuesin e duhur. Sqarohet për të gjithë nihilistët, që flasin nga poltronet politike që në asnjë rast, pikë apo nen të këtij udhëzimi nuk sugjerohet, mendohet apo konceptohet largimi nga puna i mësuesëve që plotësojnë kriteret e arsimit dhe që në punën e tyre të përditshme karakterizohen nga profesionalizmi, vlerat qytetare e humane, respekti për nxënësin e për shkollën, e matur kjo nëpërmjet monitorimeve të brendshme dhe të jashtëme, si dhe rezultateve të nxënësve në mësim. Por, ashtu siç mbron dhe promovon këtë kategori mësuesish që të gjithë dëshirojmë të shohim në shkollat tona, ashtu edhe parashikohet me ligj që drejtori i shkollës të largojë nga puna çdo mësues që nuk realizon detyrën sipas standardeve të kërkuara profesionale dhe etike. Roli i drejtuesëve është deçiziv për të shpëtuar shkollën dhe nxënësit nga kjo minorancë mësuesish, që fatkeqsisht helmatisin të tërë skemën. Mendoj se një sfidë edhe më e madhe për MAS, duhet të jetë ajo e mirëpërcaktimit të kriterëve dhe cilësisë menaxhuese të drejtuesëve të shkollave, si faktori kryesor për garantimin e suksesit në arsimin tonë parauniversitar.

Si përfundim mund të them se mënyra e re e emërimeve në arsim, është një avangardë që për herë të parë ngjallë shpresa për të patur shkollim sipas standardeve të BE edhe të fëmijëve shqiptar.

DHUNA NDAJ FËMIJËVE SHPREH EDHE DOBËSI NË PUNËN E SHKOLLËS



Fran GJOKA

Lezhë

Realisht ka përmirësime në sistemin e punës së shkollës dhe aktorëve të tjerë, që kanë për mision kultivimin e vlerave pozitive në grupmoshat shkollore. Ato shfaqen dukshëm edhe në përmirësimin e raporteve njerëzore mes palëve mësues- nxënës, nxënës – prind, nxënës - nxënës, në uljen e shkallës së agresivitetit në raportet e ndërsjella, në një klimë më të butë në marrëdhëniet mes grupeve të interesit për arsimimin dhe edukimin e brezit të ri me normat morale të një shoqërie demokratike dhe të hapur, në një mënyrë sjellje më civile për zgjidhjen e konflikteve në shkollë e jashtë saj, në zbritjen e rasteve të përdorimit të dhunës fizike e emocionale në institucionet e edukimit etj. Siç duket, këtu ka ndikuar edhe përpjekja e shoqërisë

për emancipim e qytetari si dhe masat e marra kohët e fundit nga MAS-i për vlerësimin e situatës dhe ndjekjen hap pas hapi të problemit nga strukturat drejtuese të saj. Gjithsesi, në shkolla dhe mjedise familjare, ka ende dhunë, mungesë kompromisinë zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve, shfaqje të theksuar të intolerancës në komunikim, agresivitet etj. Në pamundësi për të parë problemin në një plan të gjerë, pasi të tilla janë hapësirat e një shkrimi, në po i referohemi problemit vetëm në shkolla e në mjediset ku jetojnë e kalojnë kohën nxënësit dhe adoleshentët.

Kur mësuesi mund të dhunojë nxënësin, në çfarë situatash?

Në anketat e hapura dhe ato të mbyllura, të bëra në disa shkolla të qarkut të Lezhës, rezultoi se numrin

më të madh të nxënësve të dhunuar e përbëjnë ata që viktimizohen psikologjikisht. Siç duket, rënia e numrit të ushtrimit të dhunës fizike ndaj kësaj kategorie nxënësish, lidhet edhe me intensitetin e punës dhe masat që po merr kohët e fundit MAS-i për sensibilizimin e opinionit dhe parandalimin e fenomenit, puna e specializuar e psikologëve në shkolla, një përpjekje që duhet vazhduar e thelluar edhe në të ardhmen dhe jo të vepruar me fushata, siç kemi vepruar në shqiptarët në tërësi dhe drejtuesit e shkollave e mësuesit në veçanti.

Ajo që shfaqet dukshëm në mësim mbetet dhuna psikologjike. Së paku, kështu shprehen nxënësit dhe ky është edhe konkluzioni ynë. Ushtruesit janë mësuesit ndaj nxënësit. Ndërsa jashtë shkollës, në kohën e lirë ose në veprimtari vetë-organizuese të nxënësve, ata

që ushtrojnë dhunë psikologjike (jo vetëm psikologjike), janë nxënësit kundër nxënësve. Fatkeqësisht ushtruesit e dhunës, mësuesit, grupet e nxënësve dhe individët, siç tregojnë të dhënat, i referohen prejardhjes së "viktimit", origjinës së tij, shkallës së intelektit, dobësive që mbart në përvetësimin e programit mësimor, që më së shumti lidhen me nivelin e punës së dobët të shkollës nga ata kanë ardhur se sa nga niveli intelektual i tyre, nga paraqitja e jashtme etj. Shikojmë edhe anën tjetër të medaljes: mësuesit që po ndjehen të shqetësuar në shpjegimin e mësimin, ku nxënësit, pavarësisht paralajmërimeve që mësuesi u bën, vazhdon të prishë qetësinë e orës së mësimin. Ndodh që mësuesi humbet durimin dhe në një moment nervozizmi reagon, duke u sjellë dhunshëm ndaj fëmijëve dhe të rinjve. Kështu p.sh, rreth 4.8 % e nxënësve të anketuar pranojnë se fyhen dhe ndjehen keq nga fjala që ju drejtojnë atyre mësuesit ose shokët e shoqet e tyre, që e kanë burimin tek origjina si: katundarë, malok, etj. Rreth 3 % e fëmijëve nëpërkëmben emocionalisht nga shokët e mësuesit me fjalë të tilla, që lidhen me moshën psikologjike të tyre, si: gojëkyçur, i/e trashë etj., dhe 2% e nxënësve dhunohen emocionalisht me fjalët e shprehjet që lidhen me të metat fizike, një fatkeqësi e lindur ose e fituar, që askush nuk do ta dëshironte, si: veshëllapush, i/e shpifur, qurravec, trashaluq etj. Po të shihet me kujdes dukuria, dalim në përfundimin se shumë evidente është dhuna psikologjike, disi e fshehtë, që ushtrohet nga shkolla ndaj nxënësve të ardhur nga zona rurale dhe që janë ngulur përgjithmonë për të banuar në zonat ku vepron institucioni. Mendimi ynë, i shprehur edhe nga nxënësit, është se ajo, tek kjo kategori fëmijësh, shfaqet me frekuencë më të lartë në këto dy

raste: me formën e përjashtimit dhe vetëpërjashtimit nga jeta e shkollës e këtyre nxënësve. Një veprim i tillë fatkeqësisht nxitet edhe nga mësuesit dhe bashkëmohatarët e tyre, ndërsa drejtoritë e shkollave dhe strukturat drejtuese të nxënësve, që duhet të mbrojnë liritë dhe të drejtat e shokëve dhe shoqeve heshtin. Në situata të tilla përjashtuese dhe vetëpërjashtuese, kjo kategori nxënësish nuk vetpëlqehet, nuk vetëvlerësohet, nuk shihet e sigurtë. Rrjedhimisht stresohet dhe nuk fiton aftësinë e integritit në mjedisin e ri, çka do të thotë se dhuna emocionale do të vazhdohet të thellohet mbi ta. Në formën e paragjykimit dhe të një qëndrimi disi indiferent dhe pse kjo edhe përbuzës ndaj këtyre nxënësve që kanë edhe probleme ekonomike dhe të formimit kulturor. Për këto dy probleme unike të formimit dhe të bashkëjetesës qytetare, i takon shkollës që të krijojë mjedise e frymë bashkëpunimi e bashkëveprimi me te gjitha grupet sociale, që formojnë kolektivin, në të kundërtën rezultatet e pritshme nuk arrihen, objektivat nuk përmbushen dhe reformimi i shkollës kompromentohet.

-Cilët mësues ushtrojnë më shumë dhunë dhe pse?

Nga të dhënat del që mësuesit që ushtrojnë më shumë dhunë janë ata me eksperiencë të vogël në punë, që kanë mungesë përvoja, që nuk i zotërojnë emocionet, që nuk i njohin format e komunikimit dhe psikologjinë e grupit, sidomos raportin mes moshës kronologjike me atë psikologjike dhe që në një farë mënyre nuk janë të formuar ende si edukatorë. Për këtë kanë përgjegjësi edhe fakultetet përkatëse, që përgatisin punonjës pedagogjik, të cilët nuk e vlerësojnë formimin e mësuesve të ardhshëm si edukator ë. Fatkeqësisht strukturat përkatëse te emërimit të tyre nuk mendojnë shumë për përgatitjen e tyre tek i emërojnë në shkolla pa

përvojë dhe me kolektiva aspak të njohura për tregues në përgatitjen e nxënësve, ndaj nxënësit ankohen për mësuesit e rinj. Mësuesit e kësaj kategorie duhet të fillojnë punë në shkollat më me emër në qytet dhe në fshat dhe të jenë nën kujdesin e përhershëm për ndihmë e trajnim të kualifikuar për disa vite nga drejtuesit mësuesit dhe metodistët më të mirë që posedojnë DAR-i dhe ZA-të në rrethe.

Në grupin e mësuesve që i dhunojnë më shumë nxënësit fizikisht dhe psikologjikisht janë dhe ata që kanë disa vite pune në arsim, por që kulturalisht dhe profesionalisht janë ende larg ritmit të zhvillimit të arsimit, teknikës, shkencës dhe zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Boshllëqet në formimin e tyre shkencor e metodik, psikopedagogjik e social të tillë mësues përipiqen t'i mbulojnë me sharje e britma, duke iu hedhur fajin padrejtësisht nxënësve pas çdo kontrolli që u bëhet. Ata ose duhen trajnuar, ose një ditë duhen larguar, pasi breza nxënësish do të dalin pa bagazhin e domosdoshëm të njohurive për përballimin e kërkesave të tregut. Është edhe një kategori tjetër mësuesish që ushtrojnë dhunë për hir të një tradite të mbartur nga shkolla e sistemit komunist diktatorial dhe që shprehet hapur nga ata që mendojnë se dhunë ka edhe në parajsë, se sipas filozofisë popullore, druri ka dalë nga xheneti. Mësues të tillë nuk njohin modele alternative të sjelljes për disiplinimin e fëmijëve. Një pjesë e mësuesve janë shumë të ngarkuar fizikisht e psikologjikisht, kanë kaluar me ngarkesë dhe plot halle një jetë të tërë në arsim, tek kanë punuar me devotshmëri dhe kurrë s'janë shpërblyer nga shteti dhe shoqëria, komuniteti dhe institucionet e tjera të edukimit të asaj kohe, të gjitha këto kanë rritur tek ata nivelin e stresit dhe i ka çuar në shkarkimin padrejtësisht të tyre tek nxënësit.

Në përfundim, duhet theksuar se nxënësit janë më të predispozuar për të denancuar dhunën që ushtrojnë moshatarët dhe të rriturit ndaj tyre dhe pothuajse mungon dëshira për denancim ndaj mësuesve dhunë ushtrues. Siç duket, kjo lidhet me frikën ndaj hakmarrjes dhe flet për atë që shoqëria e shkolla nuk janë ende demokratizuar e emancipuar dhe se tërë vëmendja e atyre që merren me arsimin dhe edukimin duhet përqendruar në gjetjen e mekanizmave të reja që prodhojnë për shoqërinë e edukimin më shumë tolerancë e qytetari, emancipim e kompromis e që përjashtojnë hakmarrjen e frikën, dyfytërsinë dhe cinizmin. Çdo politikë arsimore duhet të orientohet nga qëllime të tilla.

Prindërit kërkohet të njohin më mirë fëmijët e tyre

Ky është përfundimi i pyetësorit, i cili ka brenda diçka të vërtetë. Një pjesë e prindërve nuk i njohin tipet, të tjerët nuk ja kanë idenë e krizave që përjetojnë fëmijët e tyre në kufijtë e një moshe. Ka edhe prej atyre që s'duan t'ja dinë për

interesat që fëmijët kanë për jetën, shkollën, shoqërinë dhe kulturën në tërësi. Jo pak prindër i konsiderojnë të mbaruar detyrimet ndaj fëmijëve me plotësimin e kushteve për veshmbathje, ushqim e shkollim, kur ata kanë nevojë edhe për mësim dhe argëtim plotësues. Disa prej nënave dhe baballarëve nuk e dinë se kjo moshë është në kërkim të identitetit dhe idealeve, çka nuk është e lehtë të arrihet. Një moshë e tillë e ka veçorinë psikologjike për të shijuar në këtë botë vetëm lumturi e gëzim, për të siguruar vetëm suksese dhe për të bërë qejf. Mirëpo jeta nuk mund të mendohet kurrë fushë me lule, pa kthesa e të papitura. E konceptuar ndryshe, ajo s'të jep kënaqësi, nuk të kalit vullnetin, këtë veti të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme për jetën e njeriut. Kishte të drejtë dramaturgu i njohur B. Shou kur i këshillonte të rinjtë se në se rruga nga kalon nuk përbëhet nga kthesa e vështirësi, dijeni se ajo nuk ju shpie gjëkund. Rrjedhimisht perceptimi i tyre për jetën e shoqërinë, dëshirë dhe të ardhme, shpesh herë është iluziv dhe mund të nxisë ata në kryerjen e

veprimeve të nxituara e pse jo edhe në shkarje drejt aventurës. Ka të rinj që e kanë të zhvilluar rebelizmin, prandaj mësuesit, prindërit duhet t'ua shpjegojnë këtyre nevojën për një jetë intensive sociale, për pjesëmarrje në vendimmarrje, për bashkëpunim e ndërveprim me të rriturit, për vlerësim të mundësive e kapaciteteve të tyre në kryerjen e detyrave të ngarkuara.

Mosvlerësimi i mendimeve dhe ideve të të rinjve, siç ndodh ende në disa familje, i hedh ata në pasivitet, duke bërë një jetë të varfër emocionale e shpirtërore, i fut ata në burgun e vetmisë. Pra, mungesa e aftësisë së tyre për të dalë nga kjo situatë, i hedh të rinjtë në një jetë boshe. Kultivimi i tolerancës me këta të rinj, si vlerë, i takon shkollës dhe përbën domosdoshmëri pasi ajo krijon klimë të butë dhe të përshtatshme për punë në mjediset e shkollës, motivon të rinjtë, duke pasqyruar botën e tyre emocionale dhe krijon kushte optimale për bashkëpunim në dobi të modernizimit të procesit mësimor-edukativ, me të cilët përballen shkollat tona.



DITAR ME KOMPETENCA



Njohuritë që ndërton nxënësi përmes veprimit në situata mund të vihen në zbatim vetëm kur nxënësi i ka të qarta situatat. Situatat janë thelbësore dhe të nevojshme për ndërtimin e njohurive nga nxënësi, por jo të mjaftueshme. Kështu, në fillim nxënësi koordinon veprimet e tij në situatë, pra e trajton atë në mënyrë kompetente

Ruta LEGISI

Shkolla "Kolë Jakova", Tiranë

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Rubrika : Njohuri gjuhësore.	Nënrubrika :Leksikologji	Situata e të nxënit: Shkolla dhe nxënësi.	
Tema mësimore : Fusha leksikore			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendimin e vet me gojë dhe shkrim. • Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth temës, duke bërë pyetje, sqarime, komente. • Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë kuptimin e termave; leksikologji, leksik, duke përdorur gjuhën dh e fjalorin e përshtatshëm. 2-Kompetenca e të nxënit : <ul style="list-style-type: none"> • Ndërlidh temën e re me njohuritë e tjera duke i paraqitur në forma të ndryshme të shprehurit. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore, nxënësi /ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon termin leksikologji. • Përkufizon termin fushë leksikore. • Bën dallimin midis leksikut dhe fjalorit. 		Fjalët kyçe: Leksikologji, leksik, fushë leksikore.	
Burimet : Teksti mësimorë, fjalori i gjuhës shqipe.		Lidhja me fushat e tjera zhvillon komunikimin me të gjitha fushat.	

Metoda dhe teknika mësimore PNP: stuhi mendimesh, punë e drejtuar, punë e pavarur.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Organizim, kontroll detyrash, sqarim paqartësish dhe shkruaj në tabelë: **SHKOLLA**

U drejtohem nxënësve:

-A është fjalë?

-Po.

Çfarë dimë për fjalën?

-Ka formë dhe kuptim.

-Kush ia japin fjalës formën dhe kuptimin?

-Shkronjat,tingujt.

-Cila degë e gjuhësisë i studion tingujt, shkronjat?

-Fonetika.

-Çfarë kuptojmë ne me fjalën shkolla?

Përgjigjet e nxënësve i shkruaj në dërrasë të zezë, ku them:

-Fjalën dhe kuptimin e tyre e studion dega e gjuhësisë që quhet “Leksikologji”. Fjalët i shoqëroj me shkrim në tabelë.

Hapim librat, lexohet kërkesa e dhënë në krye të mësimin, i lë nxënësit 3’ të formojnë mendimet e tyre. I shkruaj vargjet në tabelë.

Vargjet u formuan duke u lidhur fjalët me njëra-tjetrën dhe duke qenë gjithmonë në lëvizje për të dhënë mesazhe të ndryshme.

Tërësia e fjalëve të një gjuhe formon leksikon e asaj gjuhe, fjalët mblidhen në fjalorë sipas rendit alfabetik të një gjuhe, ku shoqërohen me sqarimin e kuptimeve të tyre. Fjalorët mbajnë një numër të madh të fjalëve, por jo të gjithë fjalët e një gjuhe.

Sqarohet çdo detaj e dhënë në libër rreth fushës leksikore të fjalës (**VEGLA MUZIKORE**) sqaroj:

- Çfarë janë fjalët e përgjithshme tek fusha leksikore, roli i fjalëve të veçanta.(sqarohen shembujt e dhënë në tekst).

Kalohet në dhënien e përgjigjeve të problematikave të dhëna në tekst, pasi marr përgjigjet e nxënësve them

-Çfarë mësuam sot?

- Degën e gjuhësisë që studion fjalën dhe kuptimin e sajë “Leksikologjinë”.

-Si u përdorën fjalët tek shembujt në tekst ?

– Sipas fushave të caktuara duke u lidhur me njëra –tjetrën. Ato janë vazhdimisht në lëvizje dhe fjalori i një gjuhe pasurohet vazhdimisht me anën e fjalëve.

Veprimtari zgjerimi: Shkruani fushën leksikore të fjalës “dorë”.

Vlerësime: Nxënësit i vlerësoj nisur nga aktivizimi i tyre gjatë orës së mësimin, formulimi i saktë i mendimeve me gojë dhe shkrim dhe asimilimi i kompetencave kyçe gjatë shpjegimit të mësimin.

Kompetenca nuk mund të parashikohet dhe nuk mund të përcaktohet “a priori”; ajo varet nga nxënësi ose grupi i nxënësve, nga njohuritë dhe përvoja e tyre, nga kuptimi i situatës, nga ajo që mendohet se mund të bëhet në këtë situatë, nga burimet që zotërohen në këtë situatë etj.



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE



Fusha: Gjuhë dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe (Abetare)	Shkalla: E parë	Klasa: E parë
Tema mësimore: Punimi i fletës së punës faqja 3 (Shkronja I i)		Situata e të nxënit: Shkruan shkronjën I i të madhe dhe të vogël të shtypit. Lexon fjalë dhe shkruan shkronjat që mungojnë në fjalë të ndryshme Shkruan fjalët nga fjalë me shkronja kapitale në fjalë me shkronja të vogla shtypi	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe Kompetenca e të nxënit - Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim, aktivitet, detyrë që kërkohet Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin - Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj) dhe përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Njohuritë: Tingulli dhe shkronja I i e madhe dhe e vogël e shtypit. Bashkëtingëllore, zanore, rrokje, fjalë, fjali. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - Dallon grafikun I nga i si dhe shkronja të tjera të njohura në paraabetare. - Plotëson grafikun I e madhe apo i e vogël në fjalë të ndryshme ku ato mungojnë - Analizon fjalët e shkruara në fletoren e punës faqja 3 duke i ndarë në rrokje dhe shkronja 		Fjalët kyçe: Shkronjë, rrokje, fjalë, figurë, grafiku	

Përforcimi: Analizë-sintezë. Mendo. Krijò dyshe. Diskuto

Nxënësit zgjedhin një nga fjalët e shënuara në tabelë me i në trup të tyre.
E analizojnë në rrokje e shkronja në fleta A4
Qarkohen i-të nga nxënësit.

Libri				
li		bri		
l	i	b	r	i

Pasi nxënësit kanë përfunduar vëzhgojnë në dyshe punën e njëri-tjetrit dhe e analizojnë atë.
Fjalët e punuara analizohen në tabelë nga disa nxënës të ndryshëm.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për aftësinë për të dalluar shkronjën l i në trup të fjalës.
Vlerësohen për aftësinë për të ndërtuar e analizuar fjalë me i dhe për analizën që ata i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokut.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkrimi i fjalëve të dhëna në fletoren e punës, ndarja e tyre në rrokje në flete formati A4.

- Nxënësit që paraqesin vështirësi do të shkruajnë shkronjën l, i (dy rreshta për secilën shkronjë)

Punë shtesë (me dëshirë): Modelo me materiale të riciklueshme shkronjën l, i



SI TË INTERPRETOJMË NJE POEZI NË ORËN E LETËRSISË

Vjeshtë në parakalim

*"Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër fyra tona.
Afshon erë e mekun, lëngon i zymtë dielli,
Lëngon shpirt i smum ndër krahnore tona,
Dridhet jet' e vyshkun ndër gamba të një plepi.
Ngjyrët e verdha losin në vallen e fundme -
(Dëshirë e marrë e gjethve që një nga një vdesin!)
Gëzimet, andjet tona, dëshirat e fundme
Nepër balta të vjeshtës një nga një po shkelin.
Një lis pasqyrohet në lotin e qiellit,
Tundet dhe përgjaket në pasjon të viganit:
"Jetë! Jetë unë due!"- e frymë merr
prej fellit,
Si stuhi shkynë ajrin... por në fund i
a nisë vajit.*



Vjollca Spaho

Leximi poezisë është një sfidë. Gjatë interpretimit të një poezie të suksesshme shpesh herë zbulojmë ide që nuk mund të kenë qenë në mendjen e shkrimtarit në momentin e bërjes. Poezia e mirë ka një cilësi magjike: ajo të çon drejt skutave për të zbuluar fillin e korkolepsur të përdredhjes së fjalës, e, kjo është sigurisht, magjia e poezisë. Poezia flet me ne në shumë mënyra. Edhe pse forma e saj nuk mund të jetë gjithmonë e drejtpërdrejtë, ose narrative, mësuesi i mirë i udhëheq nxënësit e vet drejt gjetjes së një kuptimi të ri të poezisë. Ndonjëherë puna e mësuesit gjatë interpretimit të një poeme është që të përgatisë pyetje për nxënësit në mënyrë që ata të thonë atë që nuk mund të thuhet

në forma të tjera të shkruarit. Gjatë orës së komentit nxënësit shkëmbejnë përvojën e tyre me poetin dhe poezinë e tij, shkëmbejnë ide, apo ndjenja të cilat në asnjë mënyrë nuk janë të gatshme. Teknikat e fjalës, ritmi, figurat letrare, shumëkuptimësia e fjalëve, të çon përtej tekstit në atë labirint duke na dhënë një përshtypje, një ide, një ndjenjë, një përvojë që nuk mund të jetë e pasqyruar drejtpërdrejt në fjalë, por që e dimë që është e vërtetë. Kështu ndodh me poezinë e Migjenit. Tek "Vjeshtë në parakalim" më tepër sesa një lirikë peizazhi është një tablo e jetës njerëzore që janë në mjerim si pasojë e shoqërisë së kohës.

Para se të merremi me poezinë mund të mësojmë disa gjëra që me leximin e parë të saj dhe sidomos duke u ndalur tek titulli. Titulli i poezisë

"Vjeshtë në parakalim" është një togfjalësh emëror ku:

Vjeshtë = një stinë + **parakalim** = emër foljor i cili përdoret vetëm për njerëzit.

Pra që në titull mund të themi që poezia është ndërtuar mbi figurën e një paralelizmi që janë:

Natyra dhe njeriu

Dy fjalët kyçe të ndërtimit të saj janë **vjeshta** dhe **njerëzit** që parakalojnë.

-Pse pikërisht vjeshta?

Vjeshta është stina ku mbizotëron ngjyra e verdhë, ku bien gjethet, pragdimri, shira, erëra. Këto janë disa tipare të vjeshtës, të cilat i gjejmë edhe në poezi.

Pse "në parakalim"?

Vështrimi artistik i Migjenit për stinën e vjeshtës nuk është empirik,

i sipërfaqshëm. Poeti është i shkrirë me poezinë dhe me atë çka ai trajton, pra me vetë natyrën e vjeshtës, por ka diçka më shumë se kaq në këtë poezi. Ndërhyrjet e tij meditative janë një nga shprehjet e kësaj shkrirje. Duke qenë një nga poetët më tendencioz të kohës, ai e mishëron tendencën e tij në figurat artistike që krijon, natyrisht, edhe duke abstraguuar me to.

Kështu ai me vjeshtën, jo vetëm na jep shoqërinë e kohës që parakalon përpara syve tanë me fytyrat e verdha si të vjeshtës,

“Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër fytrat tona”, por stina e vjeshtës zë një kult të rëndësishëm. Vjeshta e Migjenit është stina e gjithçkaje që ikën duke zbuluar kështu fatalitetin e ekzistencës me ligjin natyror, atë të vdekjes.

Kjo e dhënë artistikisht me ngjyrën e verdhë. Në konceptimin popullor vdekja simbolizohet me ngjyrën e verdhe p.sh kemi shprehjet popullore:

“I verdhë si meit”, “Dyllë i verdhë si vdekja”, etj.

“Ngjyrët e verdha losin në vallen e fundme - Dëshirë e marrë e gjethve që një nga një vdesin!”

Simbolika e vjeshtës nën ikje, në poezi rëndom është edhe simbolika

e ardhjes se një jete të re.

Po a është dhënë kjo tek Migjeni? Përgjigjja e nxënësve mund të jetë, **Po ose Jo.**

I marrim me radhë:

Jo, sepse përjetimi i vetëm i Migjenit është përjetimi i vdekjes. Ndryshe nga romantikët e tjerë, sidomos ata të cilët Migjeni i kishte idhujt e tij si: Fishta, Mjeda e themeluesi i romanit shqiptar At Ndoc Nikaj, ai e mendon gjithkund e për çdo ditë, e shikon ngado që hedh sytë, e dëshiron në çdo moment dhe, pikërisht, me këtë formë të menduarit ai del nga romantizmi.

Thirrja e Migjenit: **Vall! A ka shpëtim ndokund?!** vjen pikërisht nga kjo tendencë e tij për ta parë botën ashtu siç është, për t’u zhytur në vuajtjen e njerëzve dhe për të klithur bashkë me ta.

Po të shikojmë foljet të gjitha me ngarkesë emocionale që mbartin këtë mjerim, këtë vdekje: **afshon ere e mykun, lëngon i zymtë dielli, lëngon shpirti, dredhet jetë e vyshkun.**

Pasi ka radhitur në mënyrë panoramike element të vjeshtës, si element të jetës në ikje, do mund të themi se poeti e ka marrë elementin biologjik të vdekjes, përta kthyer në një

klithje të pashpresë. Eshë poezia që jep ikjen nga kjo jetë, jo duke shkruar me mijëra vargje duke derdhur lot, e duke mallkuar fatin, por duke arritur të japi thelbin e trishtueshëm të ekzistencës **“Jetë! Jetë unë due!”- e frymë merr prej fellit, Si stuhi shkynë ajrin... por në fund i a nisë vajit”**

Ndalemi tek ata nxënës që japin përgjigjen: Po.

Edhe pse në literaturën e shkruar për Migjenin shpesh thuhet se poeti është pesimist, tek kjo poezi ai e do jetën dhe vetë thirrja e tij: **“Vall! A ka shpëtim ndokund?!”** si fjali me nuanca dyshimi, na çon në përfundimin se ai kërkon diku një shpëtim...

Motivi biologjik i jetës dhe vdekjes ka një nuancë fatale, por kjo nuancë e tij është në antitezë të fuqishme me të ardhmen, me shpëtimin që ai kërkon, i cili jepet në mënyrë të abstraguuar, ai kërkon domosdoshmërinë e shpëtimit, por jo konkretisht se si. E ardhmja e Migjenit shpesh është e pakuptueshme, prandaj ai thërret, bërtet, kërkon shpëtim. Prandaj dhe vjeshta e Migjenit është një vjeshtë në ikje. Ai vuan për këtë dhe kjo është një vuajtje migjeniane, pra edhe në vuajtje ai shigjetoi të ardhmen.



PUNA EKIPORE SI KONTRIBUT PËR RITJEN E CILËSISË NË SHKOLLË



Luiza MYRTAJ NEZHA

DREJTORE, SHKOLLA "KONGRESI I MANASTIRIT"

Puna në grup është fenomen i botës bashkëkohore si dhe i mësimit bashkëkohor. Për shkak të ndërlkueshmërisë dhe shumëllojshmërisë së veprimtarive edukativo-mësimore, përrealizimine detyrave arsimore dhe programimin e punës në shkollë nevojitet puna ekipore e arsimtarëve, nxënësve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë me qëllim që të kemi rezultate të larta në punën tonë.

Puna ekipore në këtë drejtim ka shumë përfitime e këto të fundit janë një kontribut për rritjen e cilësisë në shkollë. Përfitime ne ndarjen e ideve, në të treguarit e shkathtësive individuale, ne outputet (prodhimet) e shpejta që sjell kjo punë, ne sienergjinë e ekipit.

Së dyti po ta shohim ne këndvështrimin pozitiv një prej përfitimeve

të punës ekipore është dhe komunikimi mes anëtarëve të ekipit.

Së fundi dua ta shoh problemin në këndvështrim jopozitiv duke analizuar pasojat negative që "rrjedhin" nga puna ekipore.

Shpeshherë detyra për të cilën punojmë është komplekse e ka nevojë për shumë njerëz me opinione e aftësi të ndryshme me qëllim që puna të kryhet me sukses. Ekipi efektivisht në total "prodhon" më pak i gjithi sesa individët e veçantë të tij, por pavarësisht nga kjo ekipet "prodhojnë ide më të mira në kuptimin që janë më të vlerësuara e më të pjekura. Ekipi gjen zgjidhjet më të mira për problemet apo detyrat me të cilat ballafaqohet.

Puna ekipore është lënda e cila mundëson njerëzit e zakonit të arrijnë rezultate të pazakonta. Askush nuk mund të jetë mësues a nxënës i mirë në çdo gjë.

Një nxënës i mirë në matematikë nuk mund të jetë po kaq i mirë dhe në anglisht ,apo një nxënës i mirë në sport nuk mund të jetë i tillë dhe në veprimtari të tjera .Në një ekip individët mund të ndajnë aftësitë më të mira në kokë ,në një projekt ku ata mendojnë se mund të japin më të mirën e tyre. Kjo është një mundësi e madhe për anëtarët e ekipit për të mësuar nga talentet dhe aftësitë e njeri-tjetrit.

Prodhimet ose outputet e shpejta janë një tjetër përfitim që sjell puna si ekip në shkollat tona .Gjatë një projekti anëtarët e ekipit ndajnë punën midis tyre .Kjo u krijon mundësi individëve të përqendrohen në detyrat e tyre të veçanta që të kontribuojnë në gjithë projektin. Kjo e bën punën më të shpejtë. Anëtarët e ekipit hyjnë në sienergji e cila paraqitet permes diskutimeve të anëtarëve e gjeneron shumë alternativa.

Dua te ndaj me ju një moment të një prej punëve ekipore të zhvilluar me rastin e Festave të Nëntorit në shkollën 9 vjeçare “Kongresi i Manastirit”, shkollë të cilën unë e drejtoj prej një viti .Për këtë veprimtari u ngrit një ekip pune i përbërë nga mësuesja e letërsisë, historisë, mësuesja e arteve ,e edukimit fizik, dhe mësuesve të tjerë. Ekipi i ngritur prej këtyre mësuesve gjeneroi shumë alternativa mendimesh. Ndamë detyrat .Ekipet e punës u munduan të bashkëpunonin duke dhënë mendime origjinale nga mësueset e lëndëve përkatëse. Po nuk mjaftoi me kaq... Në organizimin e prezantimit të projektit të gjithë mësuesit e shkollës punuan si një ekip i vetëm për të arritur në kohë dhe me cilësi organizimin e tij që në fillim e deri në fund. Gjithçka u realizua më së miri falë një pune efektive ekipore

Një anë tjetër pozitive e punës ekipore në drejtim të rritjes së cilësisë në shkolla është komunikimi midis anëtarëve të ekipit Sipas një sondazhi të kryer në 2009 nga METLIFE(Fondacioni Metlife ofron fonde per mesuesit ne shkollat amerikane)shumë nga drejtorët dhe mësuesit thonë se besojnë në krijimin e mjediseve të shkollës që lejojnë mësuesit të punojnë së bashku,”pasi kjo gjë do të ketë më shumë ndikim të madh

në përmirësimin e shanseve për suksesin e nxënësve.Në një nga sondazhet e kryera në shkollën tonë për këtë çështje u arrit pak a shumë në të njëjtin përfundim dhe më poshtë po paraqes mendimet e dy prej të intervistuarve.

“Bashkëpunimi dihet se na mundëson të hulumtojmë ide të reja dhe të analizojmë informata të reja “.“Puna në ekip e rrit kapacitetin tonë në mësim. (Nga një nxënës)

“Secili prej nesh ka diçka që duhet të mësojë dhe ka diçka që duhet ta përcjellë si dije te të tjerët” (Nga një mësues)

Çështja është se për të funksionuar një ekip është e domosdoshme që të kemi proces të të mësuarit .Por siç ndodh në çdo proces ka moment kënaqësie ,po ka dhe moment të tjera ku ne mund të dyshojmë në gjërat që jemi duke bërë.

Duke e parë punën ekipore në këndvështrimin jopozitiv dua të përmend një faktor unikal i quajtur “Hallakatje shoqërore “apo tendenca e anëtarëve të veçante të ekipit të pakësojnë përpjekjet e tyre për kryerjen e detyrës .

Kjo ndodh nga këta individë kur:

- detyra që u është ngarkuar konsiderohet si e thjeshtë ,ose si e parëndësishme;
- kur rezultati i tyre personal nuk është i indentifikueshëm .
- kur anëtarët e ekipit kanë

përshtypjen se dhe anëtarët e tjerë bëjnë të njëjtën gjë, bredhin lart e poshtë pa kontribuar për punën.

Egoizëm e jo altruizëm

Sa më shumë rritet numri i pjesëmarrësve në një ekip aq më shumë zvogëlohet hapësira për mendime personale e duhet patjetër t'i imponohesh ekipit e si rrjedhojë përkeqesohet komunikimi.

Ky komunikim i keq do të ishte dhe për shkak të atmosferës garuese të çdo individi garues .Në shkollat tona publike ku numri i anëtarëve të ekipeve mesimore është i madh dhe egoja mes kolegëve është e madhe dhe komunikimi në departamentet lëndore në disa raste lë për të dëshiruar

Dhe së fundi do të flisja për atë që unë e kam quajtur “Përgjegjshmëria e pakufizuar” Përgjegjësia është e njëjtë për të gjithë .Dhe fitorja dhe disfata duhet të ndahet me të tjerët.Kjo gjë jo pak herë nuk pëlqehet nga të gjithë.

Në fund te analizës së problemit dua të them se puna ekipore është një nga aftësitë e kërkuara në ditët e sotme.Aftësia për të punuar mirë me të tjerët në mënyrë që të arrihet një qellim i përbashkët është një çështje jetësore për të pasur harmoni në vendin e punes (në shkollë)dhe një mënyrë efikase për të kontribuar në rritjen e cilësisë në shkollë



“SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE”, PËRTEJ KUFIJVE SHQIPTARË

Prezantim i DAR Berat në “Expo 2015”



Luiza MYRTAJ NEZHA

Gloria Aliaj/ Dar-Berat

Më kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore të Lombardisë në Milano, Drejtoria Arsimore Rajonale Berat, prezantoi në Panairin Ndërkombëtar “Ekspo 2015”, në Milano të Italisë, aktivitetet e kryera në hapësirat e projektit “Shkolla si Qendër Komunitare”. Falë takimit që drejtues të DAR Berat realizuan në prill 2014-të pranë DAR-it të Lombardisë në Milano, disa nxënës fituan mundësinë që të përfaqësoheshin në Panairin “Ekspo 2015”, ku Berati pati stendën e tij të përfaqësimit, pranë strukturave të prezantimit të projekteve të shkollave italiane.

Kështu, veprimtaria e DAR

Disa nxënës fituan mundësinë që të përfaqësoheshin në Panairin “Ekspo 2015”, ku Berati pati stendën e tij të përfaqësimit, pranë strukturave të prezantimit të projekteve të shkollave italiane

Berat u zhvillua në datat 4 -7 Tetor 2015 dhe pjesë e saj ishte edhe prezantimi i projektit “Radio Green Albania”. Secili prej prezantimeve, qoftë ai i “Shkollës si Qendër Komunitare” ashtu edhe projekti i “Radio Green Albania”, patën vëmendje të veçantë të të gjithë kalimtarëve në atë stendë, veçanërisht prej strukturave qeveritare të Estonisë, të cilët qëndruan aty pothuajse gjatë gjithë performancës prezantuese jo vetëm

të Z. Hodaj, Drejtor i DAR Berat, por edhe të nxënësve të përzgjedhur, të cilët përshkruan eksperiencën e tyre, si pjesë e aktiviteteve dhe projekteve që DAR Berat ka realizuar, përmes veshjeve popullore, karakteristike të zones së Beratit.

Një pjesë e rëndësishme e parashikuar e udhëtimit ishte qëndrimi i nxënësve në familjet italiane, të cilët u kujdesën për ta, përgjatë gjithë qëndrimit atje; familjet, i përkisnin fushës

së mësimdhënies në shkollat profesionale të Lombardisë, duke u krijuar mundësinë fëmijëve edhe t'i vizitojnë këto shkolla, për të krijuar një tjetër pamje të procesit të të nxënies si dhe për të ngritur më tej urat e binjakëzimit me këto shkolla.

Në pamje të përgjithshme,

ishite një eksperiencë e veçantë për secilin prej pjesëmarrësve, sidomos për vetë nxënësit, të cilët patën mundësinë të njohin një tjetër ambient, një tjetër shkollë e me një tjetër mentalitet, e cila padiskutim, do të mbetet një pikë referimi për çdo ngjarje në vazhdim, pasi DAR

Berat nuk ndalet këtu.. Ky ishte fillimi për t'u krijuar këtyre nxënësve një njohje përtej kufijëve shqiptarë, por duke qenë në kërkim të projekteve të reja, të cilat mund të ndikojnë tek çdo fëmijë e nxënës, qoftë në pikëpamje intelektuale ashtu edhe shpirtërore!





EDUKIMI FIZIK NË SHQIPËRI, SI NË VENDET EUROPIANE

Petrit MALUSHI

Krahas lëndëve të tjera në arsimin parauniversitar edhe ajo e edukimit fizik ka qenë në fokus të përshtatjes me skeletkurrikulat e reja. Qëllimi në formë dhe përmbajtje është parë në funksion të arritjes së objektivave të temave, gruptemave, lëndës, shtrirjes brenda një viti shkollor, shtrirjes brenda një cikli shkollor dhe harmonizimit me disiplinat e tjera lëndore. Ka qenë insistimi i vazhdueshëm dhe ndjekja hap pas hapi i zëvendësimit të MAS, Rauf Dimraj, specialist i mirëfilltë i kësaj fushe, që me një punë studimore shumë serioze që në këtë drejtim nga stadi teorik të kalojë suksesshëm në zbatimin praktik në të gjitha shkollat.

Shqipëria ishte unanimisht në krah të shteteve më të përparuara europiane lidhur me përmbajtjen e lëndës së edukimit fizik dhe zhvillimin e tri orëve mësimore javore të kësaj lënde në programin mësimor

Demonstrimi i studimit, tërheqja e mendimit të specialistëve të tjerë të kësaj disipline, të mësuesve të thjeshtë të edukimit fizik rezultoi i suksesshëm. Programet e lëndës së edukimit fizik tani janë larg formës statike tradicionale, ato janë të pasuruara me tema të reja dhe ngarkesa mësimore është tri orë në javë. Orientimi në këtë linjë ka qenë në sinkron të plotë me atë çka bëhet për lëndën e edukimit fizik në shkolla, edhe në shtetet e tjera europiane. Fakti i mëposhtëm e

vërteton këtë plotësisht. Në fillim të muajit në vazhdim, nga data 1 deri më 4 tetor 2015, në kryeqytetin e Hungarisë, Budapest, Shoqata Europiane e Mësuesve të Edukimit Fizik (European Physical Education Assciotion EUPEA), zhvilloi Forumin e 26-të të saj. Në këtë shoqatë aderojnë 26 shoqata të shteteve të ndryshme europiane. Antarja e 27-të, me të drejta të plota, është Shoqata e Mësuesve të Edukimit Fizik të Shqipërisë, ShMEFSh. Kjo shoqatë, e para e këtij lloji në vendin

tonë, është e re dhe zyrtarisht është themeluar në shkurt të vitit 2015 duke përfaqësuar kështu të gjithë mësuesit e edukimit fizik në Shqipëri. Ndër të tjera në programin e saj ka për qëllim edhe ngritjen profesionale të mësuesve të edukimit fizik dhe përmirësimin e standardeve të mësimdhënies në orën e edukimit fizik në shkolla. Gjashtë muaj pas themelimit, në muajin korrik 2015, ajo u pranua si anëtare e Shoqatës Europiane të Mësuesve të Edukimit Fizik dhe një muaj më vonë, pikërisht në gusht, mori ftesën për t'u përfaqësuar në Forumin e 26-të të saj në Budapest të Hungarisë, i cili u organizua nga Federata Europiane në bashkëpunim me Federatën Hungareze të Sportit Shkollor dhe me mbështetjen e

Fondit Ndërkombëtar "Visegrad". Mësuesit shqiptarë të edukimit fizik në këtë forum europian u përfaqësuan nga presidenti i shoqatës Arben Becolli dhe anëtari i shoqatës Ervin Pepi. Sipas presidentit Becolli, pas kthimit nga kryeqyteti hungarez, në ditët e forumit u zhvillua edhe seminari me temë "Harmonizimi dhe diversiteti i kurrikulës së edukimit fizik në Europë". Po ashtu u diskutuan edhe shumë çështje të tjera ku vëmendje tërhoqën "Kurrikula e bazuar në kompetenca", "Lënda e edukimit fizik zhvillohet nga specialist i fushës", "Lënda e edukimit fizik zhvillohet tri orë në javë". Materiali përmbante përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga EUPEA vendeve anëtare, lidhur me çështje të ndryshme të kësaj teme. Në përfundim të këtij seminari

Shqipëria ishte unanimisht në krah të shteteve më të përparuara europiane lidhur me përmbajtjen e lëndës së edukimit fizik dhe zhvillimin e tri orëve mësimore javore të kësaj lënde në programin mësimor. Gjatë workshopit u diskutuan edhe rekomandimet e grupit të ekspertëve të Bashkimit Europian mbi edukimin fizik, të cilat përkonin plotësisht me Platformën e Edukimit Fiziko-Sportiv. Një ndër elementët e kësaj platforme, të demonstruar prej përfaqësuesve të delegacionit shqiptar, ishte edhe Kartela Individuale e Nxënësit si pjesë përbërëse e Testeve të fitnesit, natyrisht e realizuar me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe MAS, e cila zgjoi interesin e të pranishmëve dhe u vlerësua si një risi.



TË ZBULOSH VLERAT E FËMIJËS NËPËRMJET ARTIT



Vjollca MYFTARI

Drejtoare e kopshtit Nr. 9 Fier

Zhvillimi i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç është shumë i rëndësishëm, cilësia e të cilit ndikon drejtpërsëdrejti në të qënurit produktiv dhe të përgjegjshëm në jetën e tyre në vazhdim. Kjo për faktin se kjo moshë karakterizohet nga veçori specifike që kërkojnë një menaxhim të kujdesshëm të potencialit të tyre unik, si dhe të instalimit të modeleve të reja të suksesshme.

Për këtë arsye është treguar kujdes i veçantë nga specialistë e institucione për hartimin e

programeve të posaçme për arsimin parashkollor. Ky program është i detajuar dhe i diferencuar për secilën grup-moshë, si dhe i dokumentuar në Standardet e AP.

Përveç detyrimit ligjor dhe profesional që kemi për zbatimin e tij, jo më pak peshë ka edhe detyrimi moral e shpirtëror që ne kemi ndaj kësaj kategorie shoqërore të brishtë.

Në program përfshihen disa fusha zbatimi, të cilat ngajnë me korsitë e një autostrade. Të gjitha kërkojnë angazhime serioze, për t'u siguruar fëmijëve hapësirat e duhura për edukim cilësor.

Fusha e artit në përgjithësi, duhet të shërbejë si një emërues i përbashkët për gjithë fushat e tjera, ose si një "skenë" ku interpretohen nëpërmjet artit të gjitha konceptet dhe njohuritë e fituara në të gjitha fushat e tjera. Po ashtu dhe niveli i performancave individuale dhe kolektive shërben si një instrument ballafaqimi me objektivat e parashikuara në zbatimin e programit.. Këtë radhë e kam fjalën vetëm për artin skenik, duke i lënë radhën një here tjetër artit figurative dhe krijues gjithashtu. I gjithë angazhimi artistik është një

mënyrë e të mësuarit multidisiplinar në të cilin integrohen 3 kriteret që përcaktojnë suksesin:

- të mësuarin
- interpretimin
- zbavitjen

Përveç linjave që përmban programi, është shumë i rëndësishëm **strukturimi** i një veprimtarie artistike, për të mos realizuar thjesht riprodhime të materialeve të rastësishme.

Çdo strukturë duhet të përmbajë:

- 1- Qëllimin e veprimtarisë
- 2- Pjesëmarrësit në veprimtari (mosha e pjesëmarrësve, numri i tyre, vendi ku organizohet veprimtaria.)
- 3- Materialet letrare, muzikore, koreografike, lojëra lëvizore etj, që duhet të përvetësohen nga fëmijët. Në këtë pikë duhet të punohet me kujdes për zgjedhjen e tyre, në mënyrë që gjithçka të jetë e përshtatur me qëllimin, moshën, cilësitë individuale, interesat dhe mjedisin ku do të organizohet veprimtaria.
- 4- Hapësira kohore e mjaftueshme për përvetësim cilësor të materialit. Racionalizimi korrekt i saj, duke mos cënuar programin në tërësinë e tij, por duke i shërbyer në mënyrën më të

këndshme përvetësimit të tij.

- 5- Veshje skenike, artistike, funksionale, shoqëruar me objekte të ndryshme plotësuese.
- 6- Spektatorët pjesëmarrës, për të rritur shkallën e mbështetjes, besimit, motivimit dhe vlerësimit të fëmijëve.

Përmbajtja:

Vjersha, këngë, dramatizime, gjëza-lojë, koreografi të thjeshta e lojëra muzikore-lëvizore. Tematika dhe përzgjedhja e tyre të jetë e përshtatur me llojin e veprimtarisë.

Sasia e materialeve dhe koha fizike e shfaqjes përshtatur me moshën dhe shkallën e rezistencës së fëmijëve, në mënyrë që të mos i sforcojmë kurrë.

Metodika e punës

- 1- Prezantohet para fëmijëve lloji i veprimtarisë që do të organizohet me gjithë elementët e saj. Organizohet një bisedë e lirë për të njohur interesat, idetë dhe sugjerimet e fëmijëve në lidhje me këtë veprimtari.
- 2- Shpërndahet materiali individual në mënyrë që çdo fëmijë të ndihmohet edhe nga anëtarët e familjes.
- 3- Përsëritet disa herë, deri në përvetësim të plotë
- 4- Punohet fort për artikullimin

e pastër, rrjedhshmërinë, intonacionin, ritmin, gjestikulationin dhe prezencën skenike, (të gjitha këto hapa zhvillojnë gjuhën e folur tek fëmijët)

- 5- Punohet për të rritur dëshirën, përgjegjësinë, vullnetin dhe kënaqësinë në realizimin e roleve të ndryshme, duke i ushqyer fëmijët me emocione dhe ndjesi të bukura pozitive.

- 6- Komentohet përmbajtja e çdo materiali letrar a muzikor, koreografik, në mënyrë që fëmijët ta jetojnë emocionalisht gjithçka që interpretojnë, ta kuptojnë rëndësinë e veprimtarisë. (Në një material koreografik, fëmijët mësojnë shumë koncepte perceptuale si: para, prapa anash, majtas, djathtas, lart, poshtë, drejt, rrotullim, kërcim, shpejt, ngadalë. Të gjitha këto e të tjera koncepte harmonizohen në grup.) Po kështu ndodh me çdo material tjetër, nëse punohet me metodikë efikase.

Gjatë fazave të ndryshme të veprimtarisë forcohen shumë lidhjet me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Vihet re rritje e shkallës së interesimit, kënaqësisë dhe gatishmërisë nga ana e tyre, për gjithçka nevojitet për mbarëvajtjen.



LIBRAT E SHOKUT TIM



Në emër të revistës “Mësuesi” ku Vironi punoi dhe dha një kontribuat me shumë vlerë i urojmë: “Pension të mbarë me plot shëndet e penë të lehtë për të pasur nxënësit e shkollave, mësuesit, prindërit, ne gjyshërit, sa më shumë libra

Vjollca SPAHO

Shhtysë për këtë shkrim u bë dalja në pension, si specialist në MAS, i Z. Viron Kona. Të shkruash për një shok, që ke punuar vite e vite me radhë e keni ndarë sëbashku, jo vetëm problemet e punës, por edhe ato familjare, është sa e bukur, aq edhe e vështirë.

Por unë nuk dua të them se kush është Vironi, ku lindi ku ka punuar, si ka punuar. Për të kanë shkruar, kaq miq, shkrimtarë, publicistë, të njohur të Vironit, këto edhe të përmbledhura në një libër.

Në këtë shkrim, si fillim, në emër të revistës “Mësuesi” ku Vironi punoi dhe dha një kontribuat me shumë vlerë, jo vetëm si redaktor i saj, por më së shumti, si shkrimtar i njohur, ku mblidhte rreth redaksisë sonë të vogël, emra të mëdhenj, i urojmë:

“Pension të mbarë me plot shëndet e penë të lehtë për të pasur nxënësit e shkollave,

mësuesit, prindërit, ne gjyshërit, libra kaq të bukur!

Përgjithësisht është sa e lehtë aq edhe e përshtatshme për njeriun, të intrigoget vazhdimisht nga të panjohurat e pafundme, apo të nxisë veten që të bëhet pjesë e tyre, të cilat duke qënë në më të shumtën e rasteve të pranishme me ne, sërish e gjejnë përgjigjen në tekste artistike të tilla si ato të shkrimtarit pasionant për fëmijë dhe jo vetëm për fëmijë, Viron Kona.

Në një kohë kur informacioni është mjaft i gjerë dhe i shumanshëm, në një botë ku dija dhe kërkimi ofrojnë mundësi zgjedhjeje dhe njohjeje, shkrimi i librave që i drejtohen një lexuesi me një moshë që është kaq pranë internetit dhe që i thith rrufeshëm ndryshimet dhe arrijtet e kësaj teknologjie, mendoj që është një hap mjaft i vështirë, kurajoz dhe disi aventuros.

Ky mendim më lindëte në vitet e para të punës bashkë me Vironin, pa i lexuar librat e tij, dhe

në pyetjet e mia gjeja gjithmon të njëjtën përgjigje:

-Kam shumë libra në kokë Vjollca dhe kam në duart e fundit X libri, kam në dorëshkrim një tjetër, e.... kështu me radhë.

Për më tepër, teoritë e sotme të komunikimit, e konsiderojnë lexuesin si një pjesë të rëndësishme të vetë suksesit të autorit dhe librit, gjithnjë i drejtoja pyetjen:

- Po i lexojnë vogëlushët të gjithë këta libra?

Dhe përgjigjen e kësaj pyetje e gjeta gjatë gjithë asaj periudhe kur unë punova me Vironin, në redaksinë e gazetës “Mësuesi”, kohë që do ta ruaj gjithmonë si mjaft, jo vetëm të rëndësishme, intensive, të mrekullueshme, por edhe shumë të veçantë në mënyrën e komunikimit me njëri- tjetrin, të informacionit që unë kam marrë, jo vetëm në planin intelektual, por më shumë, atë njerëzor.

Është një privilegj për mua që kam një mik të tillë si Viron Kona.

E le të kthehemi tek librat .

Duke marrë në duar librat e Vironit, u gjenda në një situatë të tillë, ku që me titujt e tyre u intrigova, pasi tituj të tillë 'Ah, mor Bubulino', "Të çuditshmit",

"Drithërimat e Yjeve" "Yje mbi Bosfor" etje. të krijojnë mundësi komunikimi jo vetëm me një pjesë të vogël lexuesish, por me të gjithë, dhe ajo që është aq e rëndësishme, ato përçojnë mesazhe që vijnë nga thellësia e shekujve dhe nga të fshehtat e natyrës.

Dhe jo vetëm kaq, një libër arrin suksesin e tij edhe falë rekomandimit me pasion që lexuesit i bëjnë njëri-tjetrit. Çfarëdo që të thonë cinikët, unë kam bindjen që librat e Vironit kanë arritur të kënaqin jo vetëm një numër të madh lexuesish të moshës shkollore, por edhe të rriturit, pasi ne, njerëzit, jemi përpjekur e vazhdimisht do të

përpiqemi gjithmonë të ndajmë me njëri-tjetrin përjetimet që na prekin thellë.

Librat serial me personazhin aq të dashur, aq të ditur, Bubulino, janë bërë jo vet miq të fëmijëve, por nëpërmjet tyre nxënësit e shkollave, por edhe vetë shkrimtarin e kanë ndihmuar të zënë miq të rinj.

Fakti që libri u botua dhe u përkthye në Suedi dhe u krahasua me "Pipi Çorapegjatën" me autor suedez, tregon me shumë se çfarë unë po them. Mendoj se ky vëllim qëndron në themelin e letërsisë për fëmijë, por unë nuk jam aq e zonja për të marrë përsipër një studim për të evidentuar rëndësinë e tij në zhvillimin e dijeve artistike e shkencore.

Në to gjen ç'të mësosh. Duke lexuar librat e mikut tim, Viron Kona, kam qenë shumë e befasuar tek ndieja atë liri, atë guxim atë përvojë, atë njohje, atë pasuri të artit të të shkruarit dhe me kohë e kuptova që

kënaqësia e leximit të tyre nuk mund të të zbehet, pasi para syve të hapen caqet e njohurive të reja. Duke lexuar këta libra, shoh që nuk të davaritet elementët e misterit të fshehura të shkencës dhe anija kozmike ku Bubulinoja ka hipur për t'i rënë përqark botës, bëhet gjithmonë edhe më e dashur, më e tejdukshme, më interesante, më befasuese.

Sigurisht dhe padyshim, pranohet pa mëdyshje, karakteri unik i një shoku artist, duke kuptuar se pikërisht prej kësaj veçantie afirmohet personaliteti ynë. Dhe së fundi i them Vironit, jo të na japë diçka të ndryshme, por vetëm të vazhdojë në të njëjtën hulli, pasi ka për të dëgjuar gjithmonë e kurdoherë psherëtimat e lexuesit, pasi ka përfunduar një libër të tij:

-Ah, sikur të vazhdonte edhe më tej!

-Kurrë mos të pushoftë dora së shkruari libra për fëmijë!



100-VJETORI I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE, SHKOZË



Leonora RROKAJ (ISMAILAJ)

Udhëtoja përnjë vendlindjen time, në Shkozën e Kudhës Grehotit.

- Kudhës së Grehoti... Kjo krahinë e lavdishme, me një seri fshatrash të shtrirë rrëzë malit të Bardhë, i pagëzuar si "Vend i Shenjtë" ku njerëzit bëjnë një pelegrinazh, për t'u ngjitur deri te Kurora e Malit dhe për të marrë prej andej bekimin që fati i mire t'i ndjek kudo.

- Rruga automobilistike, e cila dredhon sa nga njëra anë e faqes së malit në tjetrën, lidh si një arterie fshatrat e kësaj krahine legjendare, Ploçë, Amonicë, Sevaster, Lezhan, Golimbas, Mazhar, Dushkarak dhe për të përfunduar në Shkozë, fshat i fundit për nga shtrirja gjeografike, por i pari për nga historia.

Dhe sot, si në arenën e amfitetatrit, qindra gladiatore, nxënës, mësues, banorë te komunitetit, janë mbledhur për të kujtuar caste historie nga historia e lavdishme e qytetërimit të kësaj krahine, qytetërim që nis dhe

vazhdon, pranë shkollës sonë të dashur, shkollës së fshatit tonë Shkozë...

-Në lindje të fshatit, për anë të fushës, gjarpëron lumi Vjosë, i cili shuan etjen në stinën e verës. E ndërsa makina afrohet drejt fshatit, diçka e pazakontë ndihet që larg... Arena festive është përhapur gjithandej.

- Kemi festë! - dëgjova zërat e disa fëmijëve, të cilët me lule në duar ecnin drejt shkollës.

- Po, po sot Shkoza është në festë! Ajo feston 100-Vjetorin e Çeljes së Shkolles së Parë Shqipe. Tingujt e muzikës dhe meloditë e tjera gjëmonin fuqishëm, e jehona e tyre përhapet deri në grykat dhe faqet e maleve.

- Në oborrin e shkollës janë mbledhur shumë njerëz, bijë dhe bija, veteranë dhe të rinj, ish nxënës dhe mësues. Takohemi dhe çmallemi, kujtojmë vitet kur kemi qënë nxënës të kësaj shkolle, histori pa mbarim...suksese... ecje dhe vlerësim për elitën e dalë nga dyert e kësaj shkolle.

-Sa shumë emocion, sa shumë urime për organizatorët e shoqatës "Shkoza" z.Fiqiri Aliaj dhe Dervish Mukaj, që bëjnë të mundur organizimin e këtyre eventeve me vlera të mëdha kulturore dhe historike, por edhe për të njohur rrënjët e njëri-tjetrit, nipër dhe mbesa dhe për të mbajtur gjallë vëllazërinë, paqen, dashurinë dhe për t'u lënë brezave trashgiminë kulturore dhe traditën e hershme dhe të bukur të fshatit.

-E gëzimi bëhet dyfish më i madh kur hyjmë në shkollë. Na dukej sikur ishim nxënës, sikur mësuesit që na shoqëronim do na jepnin sërish mësim.

- Ndalemi të stendat e vendosura në mur. Rikthehemi pas në kohë, kur shohim fotografi të nxënësve dhe mësuesve në vite.

Oh, ç'nostalgji !...Mësues Idajet Sinani, i pakët në trup, por i saktë në mendime dhe veprime... Pajtim Aliaj me batutat e tij, por korrekt në mësimdhënie.

Respekt për këto dy figura që nuk janë më midis nesh.

Duke parë me radhë cdo fotografi, sytë e mi të mbushur me lot ndalen te ikona e bukurisë femërore, te modeli dhe idhulli im, mësuesja e fillores, Stoli Zykaj. Ajo nguliti në mendjen time pasionin për t'u bërë një mësuese e suksesshme.

- Fotografia e saj shquante mes të tjerave dhe pse vitet bëjnë të vetën. Ajo sërish shkëlqente. E kërkova mes turmës, pyeta nëse kishte ardhur, por jo, (ndoshta kishte ndonjë arsye...)

-Ja dhe mësuesi i matematikës Dushan Murati, ...autoritar, korrekt, kërkues dhe metodist model, që më vonë, do të drejtonte këtë shkollë për shumë vjet dhe tani mësues në një nga shkollat private të qytetit. Duke parë me radhë fotot, duke biseduar dhe pyetur mësuese Myrveten dhe mësuese Hënën, për ata që nuk i njohim, degjojmë disa zëra që vinin nga shkallët:

Erdhën erdhën!

Kush? pyetëm njëzëri dhe kthym kokën pas.

-Po vinin me radhë ish mësues dhe drejtues të shkollës sonë Caush Banushi, Sezai Sinani, Beshir Murati, Dushan Murati, Ferro dhe Medie Kapaj, Elmaz Gjika, Ervehe Telharaj, Afize Telharaj, Azem Begaj, Floresha Rakipaj etj.

-Por këtij eventi nuk mund t'i shpëtonte vëmendjes dhe kujdesit të vetë ministres së arsimit Znj.Lindita Nikolla, e cila delegoi këshilltarin e saj Z. Pellumb Karameta për të qënë pjesë e kesaj feste. Ai shoqërohej nga organizatorët e shoqatës Z. Fiqiri Aliaj, Dervish Mukaj, Sinan Breshani etj.

-Drejtori i shkollës, Lelo Tare bashkë me mësuesit e shkollës, na priti në drejtori dhe sipas zakonit dhe traditës së hershme të fshatit bëri prezantimet dhe

një përmbledhje të shkurtër të historikut të shkollës. Një mësuese qerasi të ftuarit me pije dhe cokollata dhe pas këtij takimi të vogël dolëm në oborr për të festuar dhe gëzuar së bashku.

- Ish drejtori i shkollës Z. Sezai Sinani dhe anëtarët e shoqatës Sinan Breshani dhe Astrit Paja kishin përgatitur një libër me portrete dhe CV-it e mësuesve në vite dhe ua dhuroi kolegëve, të cilet me lot në sy shfletonin librin...kujtonin vitet... kolegët ...episode të ndryshme nga jeta e punës në vite.U shpërnda edhe gazeta e përmuajshme e cila sponsorizohet nga bijtë dhe bijat e dalë nga dyert e kësaj shkolle, në faqet e së cilës do të gjesh kujtime, portrete, reportazhe, histori, poezi të shkruar nga vetë dora e shkoqzotëve kudo që ndodhen brenda apo jashtë vendit dhe qe nëpërmjet shkrimeve të tyre nxjerrin mallin për vendlindjen e tyre. Për nxënësit e shkollës u bën dhurata libra dhe stilolapsa nga disa bashkëfshatarë emigrant, të cilet edhe pse të larguar duket sikur thoshnin: -"Na kujtoni edhe ne."

E në këto ndjesi dhe kujtime, tingujt e Himnit Kombëtar na ftojnë të fillojmë cermonin...

-Prezantuesja Xheni Zykaj, ish nxënëse e kësaj shkolle dhe tani studente, fton te hap këtë cermoni, ish drejtoreshën e shkollës, Hëna Bonaj.

- Më pas fjalën e rastit e merr kryetari i shoqatës z. Fiqiri Aliaj i cili i bën një analizë të hollësishtme historikut të shkollës sonë, qysh nga themelimi i saj dhe deri në ditët e sotme. Ndermjet të tjerave ai theksoi se nga dyert e kësaj shkolle, kanë dalë djem dhe vajza elitare, me grada shkencore dhe të zot në profesionet e tyre, të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë.

- Përfaqësuesi i ministrisë Z.Pellumb Karameta në fjalën e tij falenderoi organizatorët e Shoqatës " Shkoza" për ftesën dhe përshëndeti në emër të ministres Znj. Lindita Nikolla. Më pas fjalën e morën me radhë, Kryetari i Bashkisë Z. Përparim Shameti, përfaqësuesja e DAR-it Z. Leonora Rrokaj, ish drejtori i parë Z. Caush Banushi etj

-Nga shoqata u shpërndanë dhe certifikata mirënjohje, për sakrificat dhe kontributin e dhënë ndër vite, ish mësuesve dhe ish drejtuesve të shkollës.

-Grupi folklorik i fshatit këndoi këngë labe kushtuar shkollës, dhe patëriotëve shkoqzotë. Nxënësit e shkollës recituan vjersha dhe poezi të thurur nga djemtë dhe vajzat e fshatit. Festa vazhdoi nën tingujt e muzikës me këngë dhe valle nga repertori i këngëtares së fshatit Shqiponja Karafili (Poni)

-Të gjithë të gëzuar, të gjithë të emocionuar, por dhe të lumtur që u çmallëm me njëri - tjetrin . Sytë e të gjithëve flisnin shumë... E kujtimet dhe biseda do të vazhdonin në lokalin e fshatit, që sipas zakonit për të ftuarit u shtrua dreka me gatime tradicionale të krahinës. Gjatë drekës u morën mirësi dhe u ngritën dolli, u kënduan këngë labe, u treguan me humor edhe disa episode të ndodhura gjatë viteve në shkollë, për ndonjë mësues a nxënës ... Shumë kujtime ... batuta, të qeshura pa fund... E si pakuptuar orët kishin kaluar pa u ndier, e takimit po i vinte fundi.

-Pas drekës filluan të largohen një e nga një, duke u takuar me lot në sy dhe duke i premtuar njëri - tjetrit se do të vinin përsëri në përvjetore të tjerë.

Kështu u mbyll ajo ditë e bukur pranvere, në stinën e vjeshtës.



REPUBLIC OF TURKEY
MINISTRY OF NATIONAL EDUCATION

eTwinning

eTwinning

eTwinning

eTwinning

eTwinning

eTwinning

eTwinning

eTwinning



100 lekë